

التحقيق والإيضاح لكثير من مسائل
الحج والعمرة والزيارة على ضوء
الكتاب والسنة) للحرمين)

**VERIFIKIMI DHE QARTËSIMI I
SHUMË ÇËSHTJEVE QË KANË TË
BËJNË ME HAXHIN, UMREN
DHE VIZITËN E XHAMISË SË
PEJGAMBERIT NË DRITËN E
KURANIT DHE SUNETIT**

VERIFIKIMI DHE QARTËSIMI I SHUMË ÇËSHITJEVE QË KANË TË BËJNË ME HAXHIN, UMREN DHE VIZITËN E XHAMISË SË PEJGAMBERIT NË DRITËN E KURANIT DHE SUNETIT

Abdulaziz ibën Abdullah ibën Baz

VERIFIKIMI DHE SQARIMI I SHUMË ÇËSHITJEVE QË KANË TË BËJNË ME HAXHIN, UMREN DHE VIZITËN NË DRITËN E KURANIT DHE SUNETIT

nga hoxha dhe eruditi i nderuar

Abdulaziz ibën Abdullah ibën Baz

PARATHËNIA E AUTORIT

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve,
dhe fundi i lumtur është për të devotshmit. Paqja
dhe bekimet e Allahut qofshin mbi robin dhe të
Dërguarin e Tij, Muhamedin, mbi familjen dhe mbi
gjithë shokët e tij.

Sakaq:

Kjo është një broshurë e shkurtër mbi Haxhin,
vlerën dhe normat e tij, mbi rregullat që duhet të
ketë parasysh ai që dëshiron të udhëtojë për ta
kryer atë, si dhe një sqarim i përmbledhur dhe i
qartë i shumë çështjeve të rëndësishme që lidhen

me Haxhin, Umren dhe Vizitën. Në të jam përpjekur t'i përmbahem me përpikëri asaj që tregohet në Librin e Allahut dhe në Sunetin e të Dërguarit të Tij (paqja qoftë mbi të!). E kam përmbledhur si këshillë për muslimanët duke zbatuar fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿وَذَكِّرْ فَإِنَّ الذِّكْرَى تَنْفَعُ الْمُؤْمِنِينَ 55﴾

"Këshillo, se vërtet këshilla u bën dobi besimtarëve!" (Edh-Dharijat, 55) Dhe fjalën e Tij:

﴿وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ لَتُبَيِّنُنَّهُ لِلنَّاسِ وَلَا تَكْتُمُونَهُ...﴾

"Kujtoje (o Muhamed) kohën kur Allahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri se do t'ua shpjegojnë atë njerëzve dhe nuk do të fshehin asgjë nga ai..." (Al Imran, 187) Gjithashtu fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿...وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَى...﴾

"Ndihejmojeni njëri-tjetrit në punë të mira dhe në devotshmëri!" (El-Maide, 2)

Dhe në zbatim të hadithit autentik ku Profeti (paqja qoftë mbi të!) tha:

«الدِّينُ النَّصِيحَةُ، ثَلَاثًا، قِيلَ: لِمَنْ يَا رَسُولَ اللَّهِ؟ قَالَ: لِلَّهِ وَلِكِتَابِهِ وَلِرَسُولِهِ وَلَا ئِمَّةَ الْمُسْلِمِينَ وَغَاصَتْهُمْ».

"Feja është këshilla e singertë" – tri herë. E pyetën: "Ndaj kujt, o i Dërguari i Allahut?" Ai tha: "Ndaj Allahut, ndaj Librit të Tij, ndaj të Dërguarit të Tij, ndaj prijësve të muslimanëve, si dhe ndaj masave."¹

¹ Shënon Muslimi nr. 55.

Taberaniu e shënon hadithin që e përcjell Hudhejfa (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ لَمْ يَهْتَمَّ بِأَمْرِ الْمُسْلِمِينَ فَلَيْسَ مِنْهُمْ، وَمَنْ لَمْ يُصَيِّحْ وَيُؤْمِسْ نَاصِحًا لِلَّهِ وَلِرَسُولِهِ وَلِكِتَابِهِ وَلِإِمَامِهِ وَلِعَامَّةِ الْمُسْلِمِينَ فَلَيْسَ مِنْهُمْ».

"Kush nuk kujdeset për çështjet e muslimanëve, nuk është prej tyre, dhe kush nuk gdhin e nuk ngryset si këshillues i singertë për Allahun, për të Dërguarin e Tij, për Librin e Tij, për prijësin e tij dhe për të gjithë muslimanët, nuk është prej tyre»¹.

Allahut i lutem që ta bëjë të dobishme këtë broshurë për mua dhe për muslimanët, ta bëjë të singertë këtë përpjekje për Fytyrën e Tij Fisnike dhe shkak për të fituar pranë Tij Xhenetet e Lumturisë. Vërtet Ai është Dëgjues dhe Pranues. Ai na mjafton neve dhe është Mbrojtësi më i mirë.

KAPITULLI I:

ARGUMENTET E OBLIGUESHMËRISË SË HAXHIT DHE UMRES DHE NXITIMIT NË KRYERJEN E TYRE

Pasi ta keni kuptuar këtë, dijeni – Allahu ma mundësoftë mua dhe juve ta njohim të vërtetën dhe ta pasojmë atë – se Allahu i Lartësuar ua ka bërë detyrë robërve të Tij haxhillëkun në Shtëpinë e Tij të Shenjtë dhe e ka bërë atë një nga shtyllat e Islamit. Allahu i Lartësuar thotë:

¹ Transmetoi Taberani në el-Eusat nr.7469.

﴿...وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حُجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا وَمَنْ كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ﴾

"...dhe vizita e kësaj Faltoreje është detyrë mbi njerëzit; për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd." (Al Imran, 97)

Në dy Sahihët, Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«بُنِيَ الْإِسْلَامُ عَلَى خَمْسٍ: شَهَادَةِ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَأَنْ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، وَإِقَامَ الصَّلَاةِ، وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ، وَصَوْمِ رَمَضَانَ، وَحَجِّ بَيْتِ اللَّهِ الْحَرَامِ».

"Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut."¹

Transmeton Seidi në Sunenin e tij se Umer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Vërtet më ka ardhur ndërmend të dërgoj disa burra nëpër këto qytete, që të verifikojnë këdo që ka mundësi² dhe nuk e ka kryer haxhin, që t'u caktojnë atyre xhizjen. Ata nuk janë myslimanë, ata nuk janë myslimanë."³

Gjithashtu është transmetuar nga Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ka thënë: "Kush ka

¹ Buhariu nr. 8 dhe Muslimi nr. 16.

² d.m.th.: pasuri të bollshme.

³ E ka shënuar autori i Xhami el-Ehadith nr. 31221 dhe ia ka atribuuar Sunenit të Seid ibn Mensurit, por unë nuk e kam gjetur në kopjen që disponoj.

mundësi ta kryejë Haxhin dhe nuk e kryen, atëherë është njësoj nëse vdes si hebre apo si i krishterë."¹

Kush ka mundësi për ta kryer Haxhin dhe nuk e ka kryer ende, duhet të nxitojë për ta kryer atë, sepse transmetohet nga Ibën Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«تَعَجَّلُوا إِلَى الْحَجِّ - يَعْنِي الْفَرِيضَةَ - فَإِنَّ أَحَدَكُمْ لَا يَدْرِي مَا يَغْرُضُ لَهُ» [7].

"Nxitoni për ta kryer Haxhin – pra, haxhin obligativ – sepse asnjëri prej jush nuk e di se çfarë pengese mund t'i dalë." (7)²

Dhe sepse kryerja e Haxhit është obligim që duhet kryer menjëherë për atë që ka mundësi, për shkak të fjalës së qartë të Allahut të Lartësuar:

﴿...وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حُجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا وَمَنْ كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ﴾

"...dhe vizita e kësaj Faltoreje është detyrë mbi njerëzit; për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd." (Al Imran, 97) Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë në hytben e tij:

«أَيُّهَا النَّاسُ، إِنَّ اللَّهَ فَزَضَ عَلَيْكُمُ الْحَجَّ فَحُجُّوا».

"O njerëz, Allahu ua ka bërë obligim Haxhin, prandaj kryejeni Haxhin."³

¹ Transmetoi Tirmidhiu nr. 812.

² Transmetoi Ebu Davudi nr. 1732.

³ Transmetoi Muslimi nr. 1337.

Gjithashtu janë transmetuar hadithe që tregojnë për obligueshmërinë e Umres, prej tyre mund të veçojmë:

Thënia e tij (paqja qoftë mbi të!) në përgjigjen që i dha Xhibrilit, kur e pyeti rreth Islamit:

«الإِسْلَامُ أَنْ تَشْهَدَ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، وَتُقِيمَ الصَّلَاةَ، وَتُؤْتِيَ الزَّكَاةَ، وَتَحُجَّ الْبَيْتَ وَتَعْتَمِرَ، وَتَعْتَمِلَ مِنَ الْجَنَابَةِ، وَتُتِمَّ الْوُضُوءَ، وَتَصُومَ رَمَضَانَ»

"Islami është të dëshmosh se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, ta falësh namazin, ta japësh zekatin, të bësh haxhin në Qabe dhe umren, të marrësh gusël nga xhunubllëku, ta plotësosh abdesin dhe ta agjërosh ramazanin."¹ E shënojnë Ibën Huzejme dhe Darekutniu, nga hadithi i Umer bin Hattabit, Allahu qoftë i kënaqur me të, ndërsa Darekutniu ka thënë: "Zinxhiri i këtij hadithi është i vërtetë dhe i saktë."

Një prej tyre është edhe hadithi i Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), e cila e pyeti Profetin (paqja qoftë mbi të!):

«يَا رَسُولَ اللَّهِ، هَلْ عَلَى النِّسَاءِ مِنْ جِهَادٍ؟ قَالَ: عَلَيْهِنَّ جِهَادٌ لَا قِتَالُ فِيهِ: الْحُجُّ وَالْعُمْرَةُ»

"O i Dërguari i Allahut, a ka xhihad për gratë?" Profeti (paqja qoftë mbi të!) u përgjigj: "Për to ka një xhihad i cili nuk ka luftë: Haxhi dhe Umreja."² E

¹ Transmetoi Ibn Huzejmeja nr. 1.

² Transmetoi Buhariu nr. 1520.

shënojnë Ahmedin dhe Ibën Maxhe me zinxhir të saktë të transmetuesve.

Haxhi dhe Umreja janë detyrim vetëm një herë në jetë; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë në hadithin e saktë:

«الْحَجُّ مَرَّةً، فَمَنْ رَادَ فَهُوَ تَطَوُّعٌ».

"Haxhi është detyrë vetëm një herë, e kush bën më shumë se një herë, ajo është vullnetare."¹

Është sunet kryerja e shpeshtë e Haxhit dhe Umres në mënyrë vullnetare; sepse është vërtetuar në dy Sahihët, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«الْعُمْرَةُ إِلَى الْعُمْرَةِ كَفَّارَةٌ لِمَا بَيْنَهُمَا، وَالْحَجُّ الْمَبْرُورُ لَيْسَ لَهُ جَزَاءٌ إِلَّا الْجَنَّةُ».

"Umret nga njëra te tjetra janë shlyerje për mëkatet e bëra midis tyre, ndërsa Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveç Xhenetit."²

KAPITULLI II:

OBLIGUESHMËRIA E PENDIMIT PËR MËKATET DHE HEQJES DORË NGA PADREJTËSITË

Kur myslimani vendos të niset për të kryer Haxhin ose Umren, preferohet që ai të porosisë familjen dhe shokët e tij për devotshmëri ndaj

¹ Transmetoi Nesaiu nr. 2620.

² Transmetuan Buhariu nr. 1773 dhe Muslimi nr. 1349.

Allahut, e cila konsiston në zbatimin e urdhrave të Tij dhe ruajtjen e vetes nga ndalesat e Tij.

Ai duhet të shkruajë borxhet e tij; që u detyrohet të tjerëve apo që të tjerët i detyrohen atij, dhe të marrë dëshmitarë për këtë. Gjithashtu, ai duhet të shpejtojë të pendohet në mënyrë të sinqertë nga të gjitha mëkatet, sepse i Larti ka thënë:

﴿...وَتُوبُوا إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهَ الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ﴾

"Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!" (En-Nur, 31)

Përkufizimi i pendimit është: heqja dorë nga mëkatet dhe braktisja e tyre, keqardhja për mëkatet e kaluara dhe vendosmëria për të mos u kthyer në to. E, nëse i ka bërë padrejtësi njerëzve në lidhje me jetën, pasurinë ose nderin, t'ua kthejë atyre të drejtat, ose të kërkojë hallallëk prej tyre para udhëtimit të tij; sepse është transmetuar nga burime të sakta prej Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«مَنْ كَانَتْ عِنْدَهُ مَظْلَمَةٌ لِأَخِيهِ مِنْ مَالٍ أَوْ عِرْضٍ فَلْيَتَحَلَّلِ النَّوْمَ قَبْلَ أَنْ لَا يَكُونَ دِينَارٌ وَلَا دِرْهَمٌ، إِنْ كَانَ لَهُ عَمَلٌ صَالِحٌ أَخَذَ مِنْهُ بِقَدْرِ مَظْلَمَتِهِ، وَإِنْ لَمْ تَكُنْ لَهُ حَسَنَاتٌ أُخِذَ مِنْ سَيِّئَاتٍ صَاحِبِهِ فَحُمِلَ عَلَيْهِ» [13].

"Kush i ka bërë ndonjë padrejtësi vëllait të tij në pasuri ose në nder, le t'ia kërkojë hallallin sot, para se të mos ketë as dinar e as dirhem; nëse ka vepra të mira, do t'i merren atij në masën e padrejtësisë që ka bërë, e nëse nuk ka vepra të mira, do të merret

një pjesë e gjynaheve të atij që i është bërë padrejtësi dhe do të ngarkohen mbi të." (13)¹

Duhet të zgjedhë për Haxhin dhe Umren shpenzime të pastra nga pasuri e ligjshme, sepse është vërtetuar se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِنَّ اللَّهَ تَعَالَى طَيِّبٌ لَا يَقْبَلُ إِلَّا طَيِّبًا».

“Allahu është i Mirë (i Pastër) dhe e pranon vetëm të mirën (të pastrën).”²

Taberani transmeton nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِذَا خَرَجَ الرَّجُلُ حَاجًّا بِنَفَقَةٍ طَيِّبَةٍ وَوَضَعَ رِجْلَهُ فِي الْعَرَزِ فَقَادَى: لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، نَادَاهُ مُنَادٍ مِنَ السَّمَاءِ: لَبَّيْكَ وَسَعْدَيْكَ، زَادَكَ حَلَالٌ، وَرَاجِلُكَ حَلَالٌ، وَحَجُّكَ مَبْرُورٌ غَيْرُ مَأْرُورٍ، وَإِذَا خَرَجَ الرَّجُلُ بِالنَّفَقَةِ الْخَبِيثَةِ فَوَضَعَ رِجْلَهُ فِي الْعَرَزِ فَقَادَى: لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، نَادَاهُ مُنَادٍ مِنَ السَّمَاءِ: لَا لَبَّيْكَ وَلَا سَعْدَيْكَ، زَادَكَ حَرَامٌ، وَنَفَقَتُكَ حَرَامٌ، وَحَجُّكَ غَيْرُ مَبْرُورٍ».

“Kur njeriu niset për të kryer Haxhin me pasuri të pastër, e vendos këmbën në yzengji dhe thërret: ‘Të përgjigjem, o Allah, të përgjigjem!’, një thirrës nga qielli e thërret: ‘Përgjigjja jote u pranua dhe je i mirëseardhur. Furnizimi yt është hallall, kafsha jote është hallall dhe haxhi yt është i pranuar e pa gjynahe.’ Ndërsa, kur njeriu niset me pasuri të papastër, e vendos këmbën në yzengji dhe thërret: ‘Të përgjigjem, o Allah, të përgjigjem!’, një thirrës

¹ Transmetoi Buhariu nr. 2449.

² Transmetoi Muslimi nr. 1015.

nga qielli e thërret: 'As përgjigje për ty e as mirëseardhje. Furnizimi yt është haram, shpenzimi yt është haram dhe haxhi yt nuk është i pranuar.'"¹

Haxhiu duhet të mos tregojë interes (gjatë haxhit) ndaj asaj që zotërojnë njerëzit dhe duhet të mos u kërkojë gjë atyre; për shkak të fjalës së Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!):

«وَمَنْ يَسْتَعْفِفْ يُعِفَّهُ اللَّهُ، وَمَنْ يَسْتَغْنِ يُغْنِهِ اللَّهُ».

"Ai që kërkon të jetë i dëlirë, Allahu do ta bëjë të dëlirë, dhe ai që kërkon të jetë i pavarur, Allahu do ta pasurojë."²

Si dhe hadithi i Profetit (paqja qoftë mbi të!):

«لَا يَزَالُ الرَّجُلُ يَسْأَلُ النَّاسَ حَتَّى يَأْتِيَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَلَيْسَ فِي وَجْهِهِ مِرَّةٌ لَحْمٍ».

"Njeriu vazhdon t'u lypë njerëzve, derisa të vijë në Ditën e Gjykimit pa pasur asnjë copë mishi në fytyrë."³

Haxhiu duhet që me haxhin dhe umren e tij të synojë kënaqësinë e Allahut dhe Botën tjetër, si dhe afrimin tek Allahu me fjalë e vepra që e kënaqin Atë gjatë qëndrimit në ato vende fisnike. Ai duhet të ruhet me çdo kusht që me haxhin e tij të mos synojë përfitimet e kësaj bote, syfaqësinë, reputacionin apo mburrjen me të, sepse një synim i tillë është ndër më të shëmtuarit dhe bëhet shkak për

¹ Transmetoi Tabrani në el-Kebir nr. 2989.

² Transmetuan Buhariu nr. 1427 dhe Muslimi nr. 1035.

³ Transmetuan Buhariu nr. 1474 dhe Muslimi nr. 4040.

asgjësimin e veprës dhe mospranimin e saj. Siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا وَزَيَّنَّتْهَا نُوفَّ إِلَيْهِمْ أَعْمَالُهُمْ فِيهَا وَهُمْ فِيهَا لَا يُنْحَسُونَ﴾
15 أُولَئِكَ الَّذِينَ لَيْسَ لَهُمْ فِي الْآخِرَةِ إِلَّا النَّارُ وَحَبِطَ مَا صَنَعُوا فِيهَا وَبَاطِلٌ مَّا
كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿16﴾

"Atyre që duan jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do t'ua shpërblejmë krejtësisht punët e tyre dhe në të nuk do t'u lihet asgjë mangët.

Këta janë ata për të cilët në botën tjetër nuk do të ketë kurrgjë, përveç zjarrit. Do t'u shembet çdo gjë që kanë bërë në këtë jetë dhe do t'u zhvlerësohet ajo që kanë punuar." (Hud, 15-16)

Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë:

﴿مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْعَاجِلَةَ عَجَّلْنَا لَهُ فِيهَا مَا نَشَاءُ لِمَنْ نُرِيدُ ثُمَّ جَعَلْنَا لَهُ جَهَنَّمَ﴾
يَصْلَاهَا مَذْمُومًا مَذْمُورًا 18 وَمَنْ أَرَادَ الْآخِرَةَ وَسَعَىٰ لَهَا سَعْيَهَا وَهُوَ مُؤْمِنٌ
فَأُولَئِكَ كَانَ سَعْيُهُمْ مَشْكُورًا ﴿19﴾

"Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne ia shpejtojmë atij atë çka dëshirojmë t'i japim në këtë botë. Pastaj ia caktojmë Xhehenemin, në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar.

Dhe kush dëshiron botën tjetër dhe përpiqet për të në mënyrën e duhur, duke qenë besimtar, atëherë përpjekja e tyre do të jetë e vlerësuar." (El Isra, 18-19)

Është vërtetuar nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: أَنَا أَعْلَى الشُّرَكَاءِ عَنِ الشِّرْكِ، مَنْ عَمِلَ عَمَلًا أَشْرَكَ مَعِيَ فِيهِ غَيْرِي تَرَكْنَاهُ وَشِرْكُهُ» [18].

“Allahu i Madhëruar ka thënë: “Unë nuk kam nevojë për asnjë ortak. Kushdo që bën një vepër duke me bërë Mua ortak me dikë tjetër në të, Unë e braktis atë së bashku me ortakërinë e tij.”. (18)¹

Po ashtu, duhet që gjatë udhëtimit të tij të shoqërohet me njerëz të mirë, të devotshëm dhe që janë të pajisur me dije fetare, dhe të ruhet nga shoqërimi me mendjelehtët dhe të prishurit.

Ai duhet të mësojë dispozitat e Haxhit dhe të Umres, t'i kuptojë ato siç duhet dhe të pyesë të diturit për çështjet që i ka të paqarta, në mënyrë që të jetë i qartë. Kur të hipë në kafshën e tij të udhëtimit, në makinë, në avion ose në mjetet e tjera të transportit, pëlqehet që të përmendë emrin e Allahut të Lartësuar dhe ta falënderojë Atë, pastaj të bëjë tekbir tri herë dhe të thotë:

﴿...سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ 13 وَإِنَّا إِلَىٰ رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ﴾

{14}

“Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për ne, se pa Të ne këto nuk do të mund t'i kishim nën pushtet.

Dhe ne, me siguri, do të kthehemi te Zoti ynë!”
(Ez Zuhruf, 13-14)

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ فِي سَفَرِي هَذَا الْبِرَّ وَالتَّقْوَىٰ، وَمِنَ الْعَمَلِ مَا تَرْضَىٰ، اللَّهُمَّ هَوِّنْ عَلَيْنَا سَفَرَنَا هَذَا، وَاطْوِ عَنَّا بُعْدَهُ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الصَّاحِبُ فِي السَّفَرِ، وَالْخَلِيفَةُ فِي

¹ Transmetoi Muslimi nr. 2985.

الْأَهْلَ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ وَعْنَاءِ السَّفَرِ، وَكَآبَةِ الْمُنْظَرِ، وَسُوءِ الْمُنْقَلَبِ فِي الْمَالِ وَالْأَهْلِ»؛

"O Zoti im, të lus që në këtë udhëtimin tim të më mundësosh të bëj mirësi dhe të jem i devotshëm, dhe të bëj vepra me të cilat Ti je i kënaqur. O Zoti ynë, na e lehtëso neve udhëtimin tonë dhe na e shkurto distancën. O Zoti ynë, Ti je shoqëruar në udhëtim dhe mbrojtës i familjes sonë në mungesën tonë. O Zoti im, kërkoj që të më mbrosh nga vështirësitë e udhëtimit, nga pamja e dëshpëruar dhe nga telashet në pasuri dhe familje."¹

Kjo transmetohet nga burime të sakta prej Profetit (paqja qoftë mbi të!); e shënon Muslimi nga hadithi i Ibën Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!).

Gjatë udhëtimit të shpeshtojë dhikrin (përmendjen e Allahut), istigfarin (kërkimin e faljes), lutjet drejtuar Allahut të Lartësuar dhe përgjërimin ndaj Tij, si dhe leximin e Kuranit e meditimin mbi kuptimet e tij. Të jetë i kujdesshëm ndaj namazeve me xhemat dhe ta ruajë gjuhën nga fjalët e kota e thashethemet, nga përzierja në atë që nuk i takon dhe nga teprimi në shaka. Po ashtu, ta mbrojë gjuhën e tij nga gënjeshtra, përgojimi, bartja e fjalëve dhe tallja me shokët dhe me vëllezërit muslimanë.

¹ Transmetoi Muslimi nr. 1342.

Duhet të sillet mirë me shokët e tij, të mos i lëndojë, t'i urdhërojë për mirë dhe t'i ndalojë nga e keqja me urtësi dhe këshillë të mirë, sipas mundësisë.

KAPITULLI III:

MBI VEPRIMET E HAXHIUT KUR MBËRRIN NË MIKAT

Kur arrin në Mikat, është e pëlqyeshme që të lahet dhe të parfumoset; sepse transmetohet se Profeti (paqja qoftë mbi të!) i hoqi rrobat e qepura kur do të hynte në ihram dhe u la. Si dhe duke u bazuar në hadithin që transmetohet nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në dy Sahihët e cila ka thënë:

«كُنْتُ أَطِيبُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ لِإِحْرَامِهِ قَبْلَ أَنْ يُحْرِمَ، وَلِحَلِّهِ قَبْلَ أَنْ يَطُوفَ بِالْبَيْتِ»
[20]

“Unë e parfumosja të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!) për ihramin e tij para se të hynte në të, dhe për lirimin nga ihrami para se të bënte tavafin e Qabesë.” (20)¹ Dhe ngase Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e urdhëroi Aishen, kur i erdhën menstruacionet ndërkohë që kishte hyrë në ihram për umre, që të lahej dhe të hynte në ihram për haxh. Si dhe ngase Profeti (paqja qoftë mbi të!) e urdhëroi Esma bint Umejsin, kur lindi në Dhul Hulejfa, që të lahej, të vendoste një copë pëlhurë

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1539 dhe Muslimi nr. 1189.

dhe të hynte në ihram¹. Kjo tregon se gruaja, kur arrin në mikat dhe është me menstruacione ose në periudhën e lehonisë, lahet, hyn në ihram me njerëzit e tjerë dhe bën çdo gjë që bëjnë haxhinjtë, përveç tavafit, ashtu siç Profeti (paqja qoftë mbi të!) i urdhëroi Aishen dhe Esmanë.

Është e pëlqyeshme për atë që dëshiron të hyjë në ihram që të kujdeset për mustaqet, thonjtë, qimet e vendeve të turpshme dhe të nënsqetullave; të heqë pjesën që duhet të hiqet, në mënyrë që të mos ketë nevojë t'i heqë ato pas hyrjes në ihram, pasi kjo është e ndaluar. Dhe sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) i ka porositur muslimanët të tregojnë kujdes për këto gjëra në çdo kohë, siç është cekur në dy Sahihët, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«الْفِطْرَةُ خَمْسٌ: الْخِتَانُ، وَالْإِسْتِحْدَادُ، وَقَصُّ الشَّارِبِ، وَقَلَمُ الْأُظْفَارِ، وَتَنْفُ الْإِبْطِ».

“Natyrshmëria është në pesë gjëra: rrethprerjen, rruajtjen e qimeve (të vendeve të turpshme), shkurtimin e mustaqeve, prerjen e thonjve dhe shkuljen e qimeve të nënsqetullave.”²

Në Sahihun e Muslimit ceket se Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon:

¹ Transmetoi Muslimi nr. 1218.

² Transmetuan Buhariu nr. 5891 dhe Muslimi nr. 257.

«وَقَتَّ لَنَا فِي قَصِّ الشَّارِبِ، وَقَلَمِ الْأُظْفَارِ، وَتَنَفِّ الْإِبْطِ، وَحَلَقِ الْعَانَةِ: أَنْ لَا نَتْرَكَ ذَلِكَ أَكْثَرَ مِنْ أَرْبَعِينَ لَيْلَةً».

"Na është caktuar për shkurtimin e mustaqeve, prerjen e thonjve, shkuljen e qimeve të nënsqetullave dhe rruajtjen e qimeve të vendeve të turpshme: që të mos i lëmë këto më shumë se dyzet net."¹

Nesaiu e transmeton me tekstin:

«وَقَتَّ لَنَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ» [24]

"I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) na caktoi kohën..." (24)² E transmetojnë gjithashtu Ahmedi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu me tekstin e Nesaiut, ndërsa sa i përket flokëve të kokës, nuk është e ligjësuar të pritet diçka prej tyre në kohën e hyrjes në ihram, as për burrat dhe as për gratë.

Ndërsa sa i përket mjekrës, është e ndaluar të rruhet ose të pritët diçka prej saj në çdo kohë; ajo duhet të lëshohet dhe të shtohet, bazuar në hadithin që përcillet nga Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!), i cili gjendet në dy Sahihët se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«خَالِفُوا الْمُشْرِكِينَ، وَقَرُّوا اللَّحَى، وَأَخْفُوا الشَّوَارِبَ».

"Dallohuni prej idhujtarëve, lëshojini mjekrat dhe shkurtojini mustaqet!"³ Ndërsa Muslimi transmeton në "Sahihun" e tij nga Ebu Hurejra

¹ Transmetoi Muslimi nr. 258.

² Transmetoi Nesaiu nr. 14.

³ Transmetuan Buhariu nr. 2892 dhe Muslimi nr. 259.

(Allahu qoftë i kënaqur me të!), se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«جُزُوا الشَّوَارِبَ، وَأَرْحُوا اللَّحَى، خَالِفُوا الْمَجُوسَ».

"Shkurtojini mustaqet, lëshojini mjekrat, dallohuni nga mexhusët!"¹

Me të vërtetë, fatkeqësia në këtë kohë është bërë e madhe për shkak se shumë njerëz e kundërshtojnë këtë Sunet, e luftojnë mjekrën dhe kënaqen me përngjasimin me jobesimtarët dhe gratë, e sidomos ata që janë të lidhur me dijen dhe edukimin. Allahut i ankohemi për këtë fatkeqësi dhe e lusim që të na udhëzojë ne dhe mbarë muslimanët në pasimin e Sunetit, në kapjen fort pas tij dhe në predikimin e tij, edhe nëse shumica e njerëzve ia kthejnë shpinën. Na mjafton Allahu – vetëm Atij i jemi dorëzuar! Nuk ka fuqi as forcë përveçse me Allahun, të Lartin, të Madhërishmin.

Pastaj, mashkulli vesh izarin dhe ridanë, dhe është e pëlqyeshme që ato të jenë të bardha e të pastra. Po ashtu, është e pëlqyeshme që të hyjë në ihram i mbathur me sandale, bazuar në fjalën e Profetit (paqja qoftë mbi të!):

«وَلْيُحْرَمَ أَحَدُكُمْ فِي إِزَارٍ وَرِدَاءٍ وَنَعْلَيْنِ، فَإِنْ لَمْ يَجِدْ نَعْلَيْنِ فَلْيَلْبَسْ حُفَّيْنِ وَلْيَقْطَعْهُمَا حَتَّى يَكُونَ أَسْفَلَ مِنَ الْكَعْبَيْنِ»

"Le të hyjë secili prej jush në ihram me një izar, një rida dhe sandale. Nëse nuk gjen sandale, le të

¹ Transmetoi Muslimi nr. 260.

mbathë meste dhe le t'i presë ato deri poshtë kyçeve të këmbëve."¹ Transmetoi Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë.

Ndërsa gruas i lejohet të hyjë në ihram me çfarëdo veshje që dëshiron, qoftë e zezë, jeshile apo ngjyrë tjetër, duke u ruajtur nga përngjasimi me veshjen e burrave. Megjithatë, nuk i lejohet të veshë nikab dhe doreza gjatë ihramit, por duhet t'i mbulojë fytyrën dhe duart me diçka tjetër, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) e ka ndaluar gruan në ihram nga veshja e nikabit dhe dorezave. Sa i përket mendimit të disa njerëzve se ihrami i gruas duhet të jetë vetëm me ngjyrë jeshile ose të zezë, kjo nuk ka asnjë bazë.

Pastaj, pas larjes, pastrimit dhe veshjes së ihramit, e vendos me zemër hyrjen në ritualin që dëshiron, haxhin apo umren; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِنَّمَا الْأَعْمَالُ بِالنِّيَّاتِ، وَإِنَّمَا لِكُلِّ امْرِئٍ مَا نَوَى».

"Veprat janë sipas njetit, dhe secilit i takon ajo që ka bërë njet."²

Është e ligjësuar që ta shprehë njetin me gojë. Nëse njeti i tij është për Umre, thotë: "Lebbejke Umreten" ose "Allahumme Lebbejke Umreten", e nëse njeti i tij është për Haxh, thotë: "Lebbejke Haxhen" ose "Allahumme Lebbejke Haxhen"; sepse

¹ Transmetoi Muslimi nr. 1177.

² Transmetuan Buhariu nr. 1 dhe Muslimi nr. 1907.

Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka vepruar kështu. E nëse i bën nijet të dyja bashkë, e thotë telbijen për të dyja duke thënë: “Allahumme Lebbejke Umreten ue Haxhen”. Më e mira është që kjo shprehje me fjalë të bëhet pasi të hipë në mjetin e tij të udhëtimit, qoftë kafshë, makinë apo tjetër; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) e ka filluar telbijen vetëm pasi kishte hipur mbi devenë e tij dhe pasi deveja ishte nisur duke ecur nga Mikati. Ky është mendimi më i saktë nga thëniet e dijetarëve.

Shqiptimi me gojë i nijetit është i ligjësuar vetëm në çastin e hyrjes në ihram, sepse kështu është përcjellë nga Profeti (paqja qoftë mbi të!).

Ndërsa për namazin, tavafin dhe veprat e tjera, njeriu nuk duhet ta shqiptojë nijetin me gojë, në asnjërën prej tyre. Pra, nuk duhet të thotë: ‘Bëra nijet të fal këtë e këtë namaz’, e as ‘Bëra nijet të bëj tavaf’. Përkundrazi, shqiptimi i tij me gojë është prej bidateve të shpikura, ndërsa shqiptimi me zë është edhe më i shëmtuar dhe mëkat më i madh. Sikur shqiptimi i nijetit me gojë të ishte i ligjësuar, do ta kishte sqaruar Profeti (paqja qoftë mbi të!) dhe do t’ia kishte qartësuar umetit me vepër ose fjalë, dhe do ta kishin praktikuar para nesh të parët tanë të mirë.

Meqenëse kjo gjë nuk është transmetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!), as nga shokët e tij (Allahu qoftë i kënaqur me ta!), kuptohet se ajo është bidat. Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«وَشَرُّ الْأُمُورِ مُحَدَّثَاتُهَا، وَكُلُّ بِدْعَةٍ ضَلَالَةٌ»

"Ndërsa më të këqijat e çështjeve janë risitë (bidatet), dhe çdo bidat është devijim."¹ E shënon Muslimi në "Sahihun" e tij. Po kështu ka thënë:

«مَنْ أَحْدَثَ فِي أَمْرِنَا هَذَا مَا لَيْسَ مِنْهُ فَهُوَ رَدٌّ»

"Kushdo që shpik në çështjen (fenë) tonë diçka që nuk është prej saj, ajo gjë është e refuzuar."² E shënojnë Buhariu dhe Muslimi. Në një transmetim të Muslimit thuhet:

«مَنْ عَمِلَ عَمَلًا لَيْسَ عَلَيْهِ أَمْرُنَا فَهُوَ رَدٌّ».

"Kushdo që bën ndonjë vepër që nuk është në përputhje me çështjen (fenë) tonë, ajo (vepër) është e refuzuar."³

KAPITULLI IV: MIKATET VENDORE DHE PËRCAKTIMI I TYRE

Mikadet janë pesë:

I pari: Dhul-Hulejfa, i cili është mikati i banorëve të Medinës dhe që sot te njerëzit quhet: Ebjaru Ali.

I dyti: El-Xhuhfe, mikati i banorëve të Shamit. Ky është një fshat i rrënuar pranë Rabigut dhe sot njerëzit hyjnë në ihram nga Rabigu. Kush hyn në ihram nga Rabigu, ka hyrë në ihram nga mikati, sepse Rabigu gjendet pak para tij.

¹ Transmetoi Muslimi nr. 867.

² Transmetuan Buhariu nr. 2697 dhe Muslimi nr. 1718.

³ Transmetuan Buhariu nr. 2550 dhe Muslimi nr. 1718.

E treta: ẖarnul-menazil, miḳati i banorëve të Nexhdit, i cili sot quhet: Es-Sejl.

Së katërti: Jelemlen - miḳati i banorëve të Jemenit.

E pesta: Dhatu-irḳ - miḳati i banorëve të Irakut.

Këto mikate i ka caktuar Profeti (paqja qoftë mbi të!) për ata që i përmendëm, si dhe për këdo tjetër që kalon nëpër to e që ka për qëllim haxhin ose umren.

Është detyrë për këdo që kalon pranë tyre që të hyjë në ihram nga aty dhe i ndalohet t'i kalojë pa hyrë në ihram, nëse ka për qëllim të shkojë në Mekë për haxh ose umre. Kjo vlen edhe për atë që kalon nga toka por edhe për atë që kalon nga ajri, duke u bazuar në thënien e përgjithshme të Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) kur i caktoi këto mikate:

«هُنَّ لَهُنَّ، وَلَمْ يَأْتِ عَلَيْهِنَّ مِنْ غَيْرِ أَهْلِيهِنَّ، مِمَّنْ أَرَادَ الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ.»

“Ato janë për banorët e atyre vendeve dhe për çdo person tjetër që kalon andej me qëllim kryerjen e haxhit ose umren.”¹

Për atë që udhëton për në Mekë me avion me qëllim haxhin ose umren, është e ligjësuar që të përgatitet për këtë duke marrë gusël (u larë) etj, përpara se të hipë në avion. Kur t'i afrohet mikatit, ai vesh rrobat e ihramit (izarin dhe ridanë), pastaj bën telbijen për umre nëse ka kohë të mjaftueshme (për umren), e nëse koha është e kufizuar, bën

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1524 dhe Muslimi nr. 1181.

telbijen për Haxh. Nuk ka asgjë të keqe nëse i vesh rrobat e ihramit përpara se të hipë në avion ose përpara se t'i afrohet mikatit, por nuk duhet ta bëjë nijetin për të hyrë në ritual dhe as nuk duhet të bëjë telbijen, përveçse kur kalon paralel me mikatin ose i afrohet atij; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) nuk ka hyrë në ihram veçse nga mikati. Dhe është detyrë për umetin (muslimanët) pasimi i tij në këtë çështje, ashtu si edhe në çështjet e tjera të fesë; bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ...﴾

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm..." (El Ahzab, 21) Dhe sepse Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë në Haxhin e Lamtumurës:

«خُذُوا عَلَيَّ مَنَاسِكَكُمْ».

"Merrni prej meje ritet tuaja (të Haxhit)."¹

Sa i përket atij që niset për në Mekë dhe nuk ka për qëllim haxhin apo umren, si tregtari, druvari, postieri etj, ai nuk e ka obligim të hyjë në ihram, përveç nëse ai vetë dëshiron; për shkak të fjalës së Profetit (paqja qoftë mbi të!) në hadithin e lartpërmendur, kur përmendi mikatet:

«هُنَّ لَهُنَّ، وَلِمَنْ أَتَى عَلَيْهِنَّ مِنْ غَيْرِ أَهْلِهِنَّ، مِمَّنْ أَرَادَ الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ».

"Ato janë për banorët e atyre vendeve dhe për çdo person tjetër që kalon andej me qëllim kryerjen e

¹ Muslimi nr. 1297.

Haxhit ose Umren."¹ Nga kjo kuptohet se ai që kalon nga mikatet dhe nuk ka për qëllim të kryejë haxhin apo umren, nuk e ka obligim të hyjë në ihram.

Kjo është pjesë e mëshirës së Allahut ndaj robërve të Tij dhe lehtësimit të Tij për ta, andaj Atij i takon falënderimi dhe mirënjohja për këtë. Këtë e përkrah edhe fakti se Profeti (paqja qoftë mbi të!), kur erdhi në Mekë në Vitin e Çlirimit, nuk hyri në ihram, por hyri në të me helmetë në kokë, sepse ai në atë kohë nuk kishte për qëllim të kryente as haxh, as umre, por vetëm se dëshironte çlirimin e saj dhe largimin e shirkut që ishte në të.

Ndërsa ai që e ka vendbanimin brenda mikateve – si banorët e Xhiddes, Umm es-Selemit, Bahras, Sherai'it, Bedrit, Mesturas dhe vendeve të ngjashme me to – nuk e ka për detyrë të shkojë te ndonjëri prej pesë mikateve të përmendura më parë. Përkundrazi, vendbanimi i tij është mikati i tij dhe prej andej hyn në ihram për Haxh ose Umre. Nëse ai ka një vendbanim tjetër jashtë mikatit, atëherë ai ka të drejtë të zgjedhë: nëse dëshiron, hyn në ihram nga mikati, e nëse dëshiron, hyn në ihram nga vendbanimi i tij që është më afër Mekës sesa mikati. Kjo bazohet në fjalën e përgjithshme të Profetit (paqja qoftë mbi të!) në hadithin e Ibën Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!), i cili, kur përmendi mikatet, tha:

¹ Burimi i tij është cekur më lart.

«فَمَنْ كَانَ دُونَهُنَّ، فَمَهُلُهُ مِنْ أَهْلِهِ، وَكَذَلِكَ حَتَّى أَهْلُ مَكَّةَ يُهْلُونَ مِنْ مَكَّةَ» [36]

“Për këdo që banon brenda këtyre kufijve, hyrja në ihram bëhet nga vendbanimi i tij. Po kështu, edhe banorët e Mekës hyjnë në ihram nga Meka.” (36)¹² E shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Por kush dëshiron të kryejë umre dhe ndodhet brenda Harem-it (territorit të shenjtë), duhet të dalë jashtë territorit të shenjtë dhe të hyjë në ihram për Umre që andej, sepse kur Aishja i kërkoi Profetit (paqja qoftë mbi të!) të kryente umren, ai urdhëroi vëllain e saj, Abdurrahmanin, që ta nxirrte atë jashtë territorit të shenjtë e të hynte në ihram që andej. Kjo tregon se ai që kryen Umren nuk hyn në ihram për Umre nga brenda Harem-it, por hyn në ihram për të nga jashtë territorit të shenjtë.

Ky hadith e specifikon hadithin e lartpërmendur të Ibën Abasit dhe tregon se qëllimi i Profetit (paqja qoftë mbi të!) me thënien e tij:

«حَتَّى أَهْلُ مَكَّةَ يُهْلُونَ مِنْ مَكَّةَ».

“Edhe banorët e Mekës futen në ihram nga Meka.” (37)³ Kjo ka të bëjë me hyrjen në ihram për Haxh, e jo për umre. Sepse, sikur të ishte e lejuar hyrja në ihram për umre nga Haremi, do t’ia kishte lejuar këtë gjë Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe nuk do ta kishte obliguar të dilte jashtë

¹ Pjesë nga hadithi i mëparshëm.

² Femuhel-luhu: d.m.th.: vendi i bërjes së telbijes së ihramit për të.

³ Burimi i tij është cekur më lart.

Haremit. Kjo është një çështje e qartë dhe ky është mendimi i shumicës së dijetarëve, Allahu i mëshiroftë! Dhe kjo është më e sigurtë fetarisht për besimtarin, sepse kështu veprohet në përputhje me të dy hadithet. Allahu na dhëntë sukses!

Sa i përket asaj që bëjnë disa njerëz, që bëjnë sa më shumë umre pas Haxhit nga Ten'imi, Xhi'raneja apo vende të tjera, ndërkohë që ata tashmë kanë bërë një umre para haxhit, nuk ka asnjë argument për ligjshmërinë e kësaj vepre. Përkundrazi, argumentet tregojnë se është më mirë të mos bëhet kjo gjë. Kjo sepse Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) dhe sahabët e tij (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) nuk bënë umre tjetër pasi përfunduan haxhin. Aishja bëri umre nga Ten'imi vetëm për shkak se ajo nuk e kishte kryer Umren bashkë me njerëzit kur hyri në Mekë, për arsye të menstruacioneve. Prandaj, ajo i kërkoi Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) që të bënte një umre në vend të umres për të cilën kishte bërë ihram nga mikati. Dhe Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ia plotësoi kërkesën. Kështu, ajo fitoi dy umre: umren që ishte bashkë me haxhin e saj dhe këtë umre të veçantë. Prandaj, kushdo që është në një gjendje si të Aishes, nuk ka problem që të bëjë umre pas përfundimit të Haxhit. Kështu zbatohen të gjitha argumentet dhe është lehtësim për muslimanët.

Pa dyshim që angazhimi i haxhinjve në një umre tjetër pas përfundimit të haxhit, përveç umres me

të cilën kanë hyrë në Mekë, u shkakton vështirësi të gjithëve dhe shkakton dyndje e aksidente, përveçse është edhe në kundërshtim me praktikën e Profetit (paqja qoftë mbi të!) dhe Sunetin e tij. Allahu na dhëntë sukses!

KAPITULLI V:

GJYKIMI MBI PERSONIN QË ARRIN TE MIKATI JASHTË MUAJVE TË HAXHIT

Dije se ai që arrin në Mikat gjendet në dy situata:

Situata e parë kur ai arrin atje jashtë muajve të haxhit, si në Ramazan apo Shaban; suneti në këtë rast është që të hyjë në ihram për umre, duke bërë nijetin me zemër dhe duke e shqiptuar me gjuhë: "Lebbejke umreten" ose "Allahumme lebbejke umreten". Pastaj thotë telbijen e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!), e cila është:

«لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ، إِنَّ الْحَمْدَ وَالنِّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكُ، لَا شَرِيكَ لَكَ».

"Lebbejke Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejk, innel-hamde uen-ni'mete leke uel-mulk, la sherike lek." - "Të përgjigjem, o Allah, vetëm Ty të përgjigjem! Të përgjigjem Ty, Ti nuk ke ortak, të përgjigjem! Vërtet, Ty të takon falënderimi, mirësia dhe sundimi. Ti nuk ke ortak!"¹
E shpreshton Telbijen dhe përmendjen e Zotit derisa të arrijë te Qabeja. Kur arrin atje, e ndërpret

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1549 dhe Muslimi nr. 1184.

Telbijen, bën tavaf rreth Qabes shtatë herë dhe i fal dy rekate prapa mekemit. Pastaj shkon te Safaja dhe bën ecjen mes Safasë dhe Mervasë shtatë herë, pastaj i rruan flokët e kokës ose i shkurton. Me këtë përfundon umreja e tij dhe i lejohen ato gjëra, të cilat përgjatë ihramit, i kishte të ndaluara.

Rasti i dytë nëse arrin te mikati në muajt e haxhit, të cilët janë: Shevali, Dhul-Ka'de dhe dhjetë ditët e para të Dhul-Hixhes.

Një person i tillë ka mundësinë të zgjedhë mes tri gjërave: të bëjë haxhin më vete, umren më vete, ose t'i bashkojë të dyja; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!), kur arriti në mikat në muajin Dhul-Ka'de gjatë Haxhit të Lamtumirës, u dha shokëve të tij të zgjidhnin mes këtyre tri riteve. Megjithatë, Suneti për këtë person, nëse nuk ka me vete hed'jin (kafshën për kurban), është që të hyjë në ihram për Umre dhe të veprojë ashtu siç e përshekruam për atë që arrin në mikat jashtë muajve të Haxhit, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) i urdhëroi shokët e tij, kur iu afruan Mekës, që të hynin në ihram për umre, dhe ua theksoi këtë gjë në Mekë. Kështu ata bënë tavaf, sa'j, i shkurtuan flokët dhe u çliruan nga ihrami, duke iu bindur urdhrit të tij (paqja qoftë mbi të!), përveç atij që kishte me vete hed'jin (kurbanin), të cilin Profeti (paqja qoftë mbi të!) e urdhëroi të qëndronte në ihram derisa të çlirohej prej tij në Ditën e Kurbanit. Suneti për atë që ka sjellë kurban me vete është që të hyjë në ihram për

haxh dhe umre së bashku; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka vepruar kështu dhe ai e kishte sjellë kurbanin me vete. Ai i urdhëroi ata shokë të tij që kishin sjellë kurban me vete dhe kishin hyrë në ihram për umre, që t'i shtonin umres edhe telbijen (nijetin) për haxh, dhe të mos dilnin nga ihrami derisa të dilnin prej tij për të dyja bashkë ritet në ditën e Kurbanit. Nëse ai që ka sjellë kurban me vete ka hyrë në ihram vetëm për haxh, ai gjithashtu qëndron në ihram derisa të dalë nga ihrami në ditën e Kurbanit, ashtu si ai që bën haxhin e kiranit (haxhin bashkë me umren).

Nga kjo kuptohet se ai që hyn në ihram vetëm për haxh, ose për haxh dhe umre, dhe nuk ka kurban me vete, nuk duhet të qëndrojë në ihram, por Suneti për të është që ta kthejë ihramin e tij në Umre, të bëjë tavaf, sa'j, të shkurtojë flokët dhe të dalë nga ihrami, ashtu siç i urdhëroi Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) shokët e tij që nuk kishin sjellë kurban me vete. Përveç nëse frikësohet se do t'i kalojë haxhi për shkak se ka ardhur me vonesë, atëherë nuk ka problem të qëndrojë në ihramin e tij. Allahu është më i Dijshmi.

Nëse ai që është në ihram ka frikë se nuk do të mund t'i kryejë ritet e tij, sepse është i sëmurë, i frikësohet ndonjë armiku, apo diçkaje të ngjashme, është e pëlqyeshme që gjatë ihramit të thotë: “Nëse më del ndonjë pengesë, atëherë vendi i lirimit tim nga ihrami është aty ku më del pengesa.” Kjo

bazohet në hadithin e Duba-ah bint Zubejrit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), e cila tha: “O Pejgamber i Allahut, unë dua të bëj haxhin por jam e sëmurë!”, dhe Profeti (paqja qoftë mbi të!) i tha:

«حُجِّي وَاشْتَرِطِي أَنْ مَحِلِّي حَيْثُ حَبَسْتَنِي»

“Bëje haxhin dhe vendos kushtin se lirimi im nga ihrami është aty ku do të më pengojë sëmundja.”¹ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Dobia e këtij kushti është se, nëse personit që është në ihram i del një pengesë që e pengon nga përfundimi i riteve, si sëmundja apo ndalimi nga armiku, atij i lejohet të dalë nga ihrami dhe nuk ka asnjë detyrim.

KAPITULLI VI:

GJYKIMI NË LIDHJE ME HAXHIN E FËMIJËS SË VOGËL, A VLEN AI PËR HAXHIN E DETYRUESHËM?

Haxhi i djalit të vogël dhe i vajzës së vogël është i saktë, bazuar në atë që transmetohet në Sahihun e Muslimit nga Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!), se një grua ia ngrii (afroi) Profetit (paqja qoftë mbi të!) një djalë të vogël dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, a ka haxh për këtë?" Ai tha:

«نَعَمْ، وَلَئِكَ أَجْرٌ» [40]

“Po, dhe për ty ka shpërblim.” (40)²

¹ Transmetuan Buhariu nr. 5089 dhe Muslimi nr. 1207.

² Transmetoi Muslimi nr. 1336.

Në "Sahihun e Buhariut" shënohet nga Saib ibën Jezidi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se ka thënë: "Më morën me vete në haxh me të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!), kur isha shtatë vjeç."¹ Por ky haxh nuk e plotëson detyrën e haxhit obligativ.

Po kështu robi dhe robëresha e kanë të saktë haxhin, por nuk i liron nga detyrimi i haxhit të detyrueshëm (farz); argument për këtë është hadithi i Ibën Abbasit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!), se Pejgamberi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

«أَيُّمَا صَبِيٍّ حَجَّ، ثُمَّ بَلَغَ الْحِنْثَ، فَعَلَيْهِ أَنْ يَحُجَّ حَجَّةً أُخْرَى، وَأَيُّمَا عَبْدٍ حَجَّ، ثُمَّ أُعْتِقَ، فَعَلَيْهِ حَجَّةٌ أُخْرَى»

"Cilido fëmijë që kryen haxhin, pastaj arrin moshën madhore, e ka obligim të kryejë një haxh tjetër, dhe cilido rob që kryen haxhin, pastaj lirohet, e ka obligim të kryejë një haxh tjetër."² E shënojnë Ibën Ebi Shejbe dhe Bejhekiu me zinxhir të mirë të transmetuesve.

Nëse djali nuk ka arritur ende moshën në të cilën arrin t'i dallojë gjërat, nijetin për ihramin e tij e bën kujdestari i tij, i heq rrobat e qepura dhe bën telbijen në emër të tij. Me këtë, fëmija bëhet muhrim dhe i ndalohen gjërat që i ndalohen muhrimin të rritur. Po kështu, për vajzën që nuk e

¹ Transmetoi Buhariu nr. 1858.

² Transmetoi Ibn Ebi Shejbe 4/444.

ka arritur ende këtë moshë, nijetin për ihramin e saj e bën kujdestari i saj; ai bën telbijen në emër të saj dhe me këtë ajo bëhet muhrime dhe me këtë asaj i ndalohen gjërat që i ndalohen muhrimes së rritur. Duhet që ata të dy t'i kenë rrobat dhe trupin të pastër gjatë tavafit, sepse tavafi i ngjan namazit, dhe pastërtia është kusht për vlefshmërinë e tij.

Nëse djali dhe vajza janë në moshën që kuptojnë dhe dallojnë gjërat, ata e bëjnë vetë ihramin e tyre me lejen e kujdestarit të tyre dhe gjatë bërjes së ihramit veprojnë ashtu siç vepron i rrituri; lahen, parfumosen etj. Kujdestari i tyre është ai që kujdeset për çështjet dhe interesat e tyre, qoftë ai babai, nëna e tyre apo dikush tjetër. Kujdestari kryen për ta ato rite që ata nuk mundën t'i bëjnë vetë, siç është hedhja e guralecëve në Xhemeratë etj. Ndërsa ritualet e tjera, si: qëndrimi në Arafat, bujtja në Mina dhe Muzdelife, tavafi dhe sa'ji, ata duhet t'i bëjnë vetë. Nëse nuk janë të aftë të bëjnë tavafin dhe sa'jin, atëherë tavafin dhe sa'jin e bëjnë duke i mbartur kujdestari apo dikush tjetër. Dhe më e mira për atë që i mbart është që të mos i bëjë tavafin dhe sa'jin të përbashkët mes tij dhe atyre, por të bëjë nijet për tavafin dhe sa'jin vetëm për ta, dhe të bëjë për vete një tavaf të tjetër dhe një sa'j tjetër; për të mbrojtur adhurimin dhe për të vepruar sipas hadithit fisnik:

«دَعْ مَا يَرِيكَ إِلَى مَا لَا يَرِيكَ».

“Lëre atë që të ngjall dyshim dhe kapu pas asaj që nuk të ngjall dyshim.”¹ Nëse mbartësi i fëmijës bën nijet për tavaf për veten e tij dhe për atë që po mbart, kjo vlen sipas mendimit më të saktë; sepse Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) nuk e urdhëroi gruan që e pyeti për haxhin e fëmijës që të bënte tavaf vetëm për të. Sikur kjo të ishte obligim, ai (paqja qoftë mbi të!) do ta kishte sqaruar. Suksesi është në Dorën e Allahut.

Djali dhe vajza që i kuptojnë dhe i dallojnë gjërat urdhërohen të marrin abdes dhe gusël dhe pastrohen nga ndyrësitë para se të fillojnë tavafin, ashtu si muhrimi i rritur. Bërja e ihramit për djalin dhe vajzën e vogël nuk është obligim për prindin e tyre, por është vepër vullnetare. Nëse e bën këtë, ai ka shpërblim, e nëse nuk e bën, nuk ka asgjë të keqe. Allahu është më i Dijshmi.

KAPITULLI VII:

SHPJEGIMI RRETH NDALESAVE TË IHRAMIT DHE GJËRAVE TË LEJUARA PËR MUHRIMIN (PERSONI QË KA HYRË NË IHRAM)

Pas bërjes së nijetit të ihramit, muhrimit - qoftë mashkull apo femër - nuk i lejohet të heqë qimet, të presë thonjtë apo të parfumoset.

¹ Transmetoi Tirmidhiu nr. 2518.

Mashkullit në veçanti nuk i lejohet të veshë rroba të qepura në formën e tërë trupit të tij, pra: në formën në të cilën janë prerë dhe qepur, si këmisha, ose në formën e një pjese të tij, si fanella, pantallonat, mestet dhe çorapet. Përrjashtim bën rasti kur nuk gjen izar, atëherë i lejohet të veshë pantallona. Po ashtu, ai që nuk gjen sandale (nallane), i lejohet të mbathë meste pa i prerë, për shkak të hadithit të Ibën Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) që gjendet në dy Sahihët, se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ لَمْ يَجِدْ نَعْلَيْنِ، فَلْيُلْبِسْ خُفَّيْنِ، وَمَنْ لَمْ يَجِدْ إِزَارًا، فَلْيُلْبِسْ سَرَائِيلَ».

"Ai që nuk gjen sandale, le të veshë mestet, dhe ai që nuk gjen izar, le të veshë shalvare."¹

Sa i përket asaj që përmendet në hadithin e Ibën Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) lidhur me urdhrin për prerjen e mesteve nëse dikush ka nevojë t'i veshë ato për shkak të mungesës së sandaleve, ai urdhër është i anuluar; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) urdhëroi për këtë në Medine, kur u pyet se çfarë duhet të veshë muhrimi. Më pas, kur u mbajti hytbe njerëzve në Arafat, ai lejoi veshjen e mesteve në rast të mungesës së sandaleve dhe nuk urdhëroi për prerjen e tyre. Në këtë hytbe ishin të pranishëm edhe ata që nuk e kishin dëgjuar përgjigjen e tij në Medine. Rregulli juridik thotë se shtyrja e sqarimit të çështjes nga koha e nevojës

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1841 dhe Muslimi nr. 1179.

nuk është e lejuar, siç është e shtjelluar në dy shkencat e Usulit të Hadithit dhe Fikhut. Me këtë vërtetohet anulimi i urdhrit për prerjen e mesteve. Sikur prerja e tyre të ishte obligim, ai (paqja qoftë mbi të!) do ta kishte sqaruar. Allahu është më i Dijshmi.

Lejohet për atë që është në ihram të veshë mestet që janë nën kyçet e këmbëve, sepse ato janë të llojit të sandaleve (nallaneve).

Lejohet nyjëzimi i izarit dhe lidhja e tij me fije peri apo me diçka të ngjashme, pasi mungon argumenti që e ndalon këtë.

Atij që është në ihram i lejohet të lahet, të lajë kokën dhe ta fërkojë atë me butësi dhe lehtësi nëse ka nevojë, dhe nëse për këtë shkak i bie ndonjë qime nga koka, nuk ka asnjë problem.

Gruaja që është në ihram e ka të ndaluar të veshë mbulesë të qepur për fytyrën, si burka dhe nikabi, apo për duart, si dorezat; për shkak të fjalës së Profetit (paqja qoftë mbi të!):

«وَلَا تَتَّقِبِ الْمَرْأَةُ الْمُحْرَمَةُ، وَلَا تَلْبَسِ الْقَفَّازِينَ» [45]

"Gruaja që është në ihram nuk duhet ta mbulojë fytyrën, e as të veshë doreza." (45)¹ (E shënon Buhariu) Dorezat janë veshje të qepura ose të thurura prej leshi, pambuku etj, sipas masës së duarve.

¹ Transmetoi Buhariu nr. 1838.

Asaj i lejohen veshjet e tjera të qepura, si: këmisha, pantallonat, mestet, çorapet etj.

Po ashtu, i lejohej të lëshojë shaminë mbi fytyrën e saj nëse lind nevoja, pa përdorur lidhëse. Nëse shamia ia prek fytyrën, ajo nuk ka asnjë përgjegjësi për këtë, bazuar në hadithin e Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), e cila ka thënë: "Kalorësit kalonin pranë nesh, ndërkohë që ne ishim me të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!) në ihram. Kur ata ishin përballë nesh, secila prej nesh lëshonte xhilibabin e saj nga koka mbi fytyrë, e kur kalonin, e zbulonim." (46)¹ E shënojnë Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe. Darekutniu e shënon një transmetim të ngjashëm me të nga Ummu Seleme.

Gjithashtu, nuk ka problem që ajo t'i mbulojë duart me rrobën e saj ose me diçka tjetër. Ajo e ka për detyrë të mbulojë fytyrën dhe duart e saj nëse është në prani të burrave të huaj, sepse ajo është duhet të mbulohet prej tyre; bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿...وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ...﴾

"...dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveçse për bashkëshortët e tyre..." (En Nur, 31) Pa dyshim se fytyra dhe duart janë prej stolive më të mëdha.

Mirëpo çështja e fytyrës është edhe më e rëndë. Allahu i Lartësuar thotë:

¹ Transmetoi Ebu Davudi nr. 1833.

﴿...وَإِذَا سَأَلْتُمُوهُنَّ مَتَاعًا فَاسْأَلُوهُنَّ مِنْ وَرَاءِ حِجَابٍ ذَلِكُمْ أَطْهَرُ لِقَوْلِكُمْ
وَقُلُوبِهِنَّ...﴾

"...kur të kërkonit prej grave të Profetit diçka, kërkojeni prapa perdes! Kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të atyre..." (El Ahzab, 53)

Sa i përket zakonit të shumë grave për të vendosur një lidhëse nën shami për ta ngritur atë nga fytyra, kjo nuk ka bazë në fe, me sa dimë ne. Sikur kjo gjë të ishte e ligjshme, i Dërguari (paqja qoftë mbi të!) do t'ia kishte sqaruar umetit të tij dhe nuk do t'i lejohej të heshte për të.

I lejohet burrit dhe gruas që janë në ihram t'i lajnë rrobat e ihramit nga papastërtia ose diçka e ngjashme, dhe u lejohet t'i ndërrojnë me të tjera gjithashtu.

Po ashtu, nuk i lejohet muhrimit të veshë rroba të lyera me shafran ose vers, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) e ka ndaluar këtë gjë në hadithin e Ibën Umerit, Allahu qoftë i kënaqur me të dy.

Ai që është në ihram duhet të braktisë fjalët e ndyra, mëkatet dhe grindjet. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿الْحَجُّ أَشْهُرٌ مَعْلُومَاتٌ فَمَنْ فَرَضَ فِيهِنَّ الْحَجَّ فَلَا رَفَثَ وَلَا فُسُوقَ وَلَا جِدَالَ فِي
الْحَجِّ...﴾

"Haxhi kryhet në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë Haxhin, le të ruhet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet..." (El Bekare, 197)

Është vërtetuar nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«مَنْ حَجَّ، فَلَمْ يَرْفُثْ، وَلَمْ يَفْسُقْ، رَجَعَ كَيَوْمٍ وَلَدَتْهُ أُمُّهُ».

"Ai që e kryen haxhillëkun në Qabe, duke u larguar nga çdo veprim intim bashkëshortor a fjalë e pahijshme dhe nga mëkatet, kthehet (i pastër nga mëkatet) sikurse ditën që e ka lindur nëna."¹ Rafeth-i i referohet marrëdhënieve seksuale, si dhe fjalëve e veprave të turpshme; Fusuk-u nënkupton mëkatet; dhe Xhidal-i është grindja për gjëra të kota, ose për gjëra të padobishme. Ndërsa sa i përket polemikës në mënyrë të mirë për të shfaqur të vërtetën dhe për të hedhur poshtë të pavërtetën, nuk ka gjë të keqe në të, madje është e urdhëruar; bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ...﴾

"Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë..." (En Nahl, 125)

I ndalohet mashkullit që është në ihram të mbulojë kokën e tij me diçka që i qëndron ngjitur, si kapele, shall, turban etj, po ashtu edhe fytyrën; për shkak të fjalës së Profetit (paqja qoftë mbi të!) lidhur me atë që ra nga kafsha e tij ditën e Arafatit dhe vdiq:

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1521 dhe Muslimi nr.1350, nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të.

«اغْسِلُوهُ بِمَاءٍ وَسِدْرٍ، وَكَفُّوهُ فِي ثَوْبَيْهِ، وَلَا تَحْمَرُوا رَأْسَهُ، وَلَا وَجْهَهُ، فَإِنَّهُ يَبْعَثُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ مُلَبَّيًّا»

"Lajeni me ujë dhe sidër, qefinoseni në dy pëlhurat e tij, dhe mos ia mbuloni kokën dhe as fytyrën, sepse ai do të ringjallet Ditën e Kiametit duke bërë telbijen."¹ Ky hadith është muttefekun alejhi, ndërsa ky version është i Muslimit.

Ndërsa, sa i përket mbrojtjes nga dielli nëpërmjet tavanit të makinës, çadrës etj, nuk ka problem, sepse kjo është njësoj si mbrojtja nga dielli me anë të tendës apo pemës dhe sepse është vërtetuar nga hadithe të sakta se Profetit (paqja qoftë mbi të!) i bënin hije me një rrobë kur hidhte gurët në Xhemretul Akabe dhe se i ndërtuan një tendë në Nemira ku ai qëndroi nën hijen e saj derisa kaloi mesdita e ditës së Arafatit.

Muhrimit (pelegrinit), burrë apo grua, i ndalohet vrasja e gjahut të tokës, bashkëpunimi në vrasjen e tij apo trembja e gjahut që të dalë nga vendstrehimi i tij, si dhe kryerja e aktit të martesës, marrëdhëniet intime, fejesa dhe prekja e grave me epsh; për shkak të hadithit të Uthmanit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

«لَا يَنْكِحُ الْمُحْرَمُ وَلَا يُنْكَحُ وَلَا يَخْطُبُ»

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1521 dhe Muslimi nr. 1350.

"Muhrimi as nuk martohet, as nuk marton të tjerët dhe as nuk fejohe."¹ E shënon Muslimi.

Nëse personi në ihram vesh rroba të qepura, mbulon kokën, apo parfumohet nga harresa a padija, nuk detyrohet të shpaguaj, por e ndërpret atë veprim sapo të kujtohet ose sapo të mësojë se nuk lejohet. Po ashtu, kush rruan kokën, shkurton diçka nga flokët e tij, apo i pret thonjtë nga harresa a padija, nuk ka asnjë detyrim, sipas mendimit më të saktë.

Muslimanit, qoftë në ihram apo jo, mashkull apo femër, i ndalohet të vrasë gjahun e Haremit (zona e shenjtë) dhe të ndihmojë në vrasjen e tij me ndonjë mjet, shenjë apo diçka të ngjashme.

Ndalohet trembja e tij nga vendi i tij, dhe ndalohet prerja e pemëve të vendit të shenjtë e bimëve të tij të gjelbra, si dhe marrja e sendeve të gjetura, përveç atij që e merr për ta shpallur. Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«فَإِنَّ هَذَا الْبَلَدَ - يَعْنِي مَكَّةَ - حَرَامٌ بِحُرْمَةِ اللَّهِ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ، لَا يُعْصَدُ شَوْكُهُ، وَلَا يُنْفَرُ صَيْدُهُ، وَلَا يُنْقَطُ لِقَطْعُهُ إِلَّا مَنْ عَرَفَهَا، وَلَا يُخْتَلَى خِلَاهَا»

"Ky vend – pra Meka – është i shenjtë, ngase Allahu e ka shenjtëruar, deri në Ditën e Kiametit. Nuk priten gjembat e tij, nuk trembet gjahu i tij, sendi i gjetur në të nuk merret, përveç atij që e merr për ta

¹ Transmetoi Muslimi nr. 1409.

shpallur, dhe nuk shkulen bimët e tij."¹ Shënon Buhariu dhe Muslimi.

Fjala "Munshid" do të thotë: shpallës. Fjala "El-Khala" do të thotë: bimësia e njomë. Minaja dhe Muzdelifeja janë pjesë e Haremit (zona e shenjtë), ndërsa Arafati nuk bën pjesë në zonën e shenjtë.

KAPITULLI VIII:

VEPRIMET E HAXHIUT KUR HYN NË MEKË DHE FORMA E KRYERJES SË TAVAFIT PAS HYRJES NË XHAMINË E SHENJTË

Kur personi në ihram arrin në Mekë, është e preferuar për të që të marrë gusël para se të hyjë në të, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) e ka bërë këtë. Kur të arrijë në Xhaminë e Shenjtë, është e pëlqyeshme të hyjë me këmbën e djathtë dhe të thotë: "Në emër të Allahut, paqja dhe bekimet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut. I kërkoj mbrojtje Allahut të Madhërishëm me Fytyrën e Tij Fisnike dhe pushtetin e Tij të amshueshëm nga shejtani i mallkuar. O Allah, më hap dyert e mëshirës Sate." Kjo lutje thuhet edhe kur hyn në xhami të tjera dhe, me sa di unë, nuk ka ndonjë dhikër të veçantë për hyrjen në Xhaminë e Shenjtë që të jetë vërtetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!).

Kur arrin te Qabja, e ndërpret Telbijen para se të fillojë tavafin, nëse është duke kryer haxhin e

¹ Buhariu nr. 1834 dhe Muslimi nr. 1353.

temet-tuit ose umren. Pastaj i afrohet Gurit të Zi dhe kthehet me fytyrë nga ai, dhe e prek me dorën e djathtë dhe e puth, nëse mundet, pa i lënduar njerëzit duke u shtyrë. Gjatë prekjes së tij thotë: "Bismil-lahi vall-llahu ekber", ose thotë: "Allahu ekber". Nëse e ka të vështirë ta puthë, e prek me dorë ose me shkop apo diçka tjetër të ngjashme dhe e puth atë të cilën e ka përdorur për të prekur gurin. E nëse e ka të vështirë ta prekë, bën shenjë drejt tij me dorë apo me diçka tjetër dhe thotë: "Allahu Ekber", dhe nuk e puth dorën apo çfarëdo që ka përdorur për të bërë me shenjë. Kusht për vlefshmërinë e tavafit është që personi të jetë i pastër nga papastërtia e vogël dhe e madhe (të ketë abdes dhe gusël), sepse tavafi është sikurse namazi, me përjashtim që në të lejohet të flitet. Gjatë tavafit, ai duhet ta ketë Qaben në anën e tij të majtë. Është mirë që në fillim të tavafit të thotë: "O Zot, nga besimi në Ty, nga besimi në Librin Tënd, nga përmbushja e premtimit Tënd dhe nga pasimi i sunetit të Pejgamberit Tënd, Muhamedit (paqja qoftë mbi të!)", sepse kjo është transmetuar nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!). Mandej bën shtatë xhiro, duke bërë remel (ecje e shpejtë) në të tri xhirot e para të tavafit të parë, i cili është tavafi që kryhet sapo arrihet në Mekë, qoftë kur personi është duke kryer umre, haxhin e temet-tuit, apo ka hyrë në ihram vetëm për haxhin (pa umren), apo e ka bashkuar haxhin me umren. Në katër xhirot e

tjera ecën normalisht. Çdo xhiro e fillon nga Guri i Zi dhe e përfundon po aty.

Remeli është ecja e shpejtë me hapa të shkurtër, dhe është e pëlqyer të bëjë idtibanë në të gjitha xhirot e këtij tavafi, dhe jo në ndonjë tavaf tjetër. Idtibaja është të vendosë mesin e rrobës nën sqetullën e djathtë dhe dy skajet e saj mbi shpatullën e majtë.

Nëse dyshon në numrin e xhirove të Tavafit, bazohet në numrin për të cilin është i sigurt, që është numri më i vogël; nëse dyshon a ka bërë tri xhiro apo katër, i llogarit tri. Kështu veprohet edhe nëse dyshon në xhirot e Sajit.

Pas përfundimit të këtij tavafi, para se të falë dy rekatet e tavafit, ai e hedh pëlhurën e tij mbi dy supet ndërsa dy skajet e saj i vendos mbi gjoks.

Ndër gjërat për të cilat duhen qortuar dhe paralajmëruar femrat, është tavafi i tyre me stoli dhe me aroma të mira, si dhe mos bërja kujdes në mbulimin e trupit, pasi ato janë auret. Prandaj, ato e kanë obligim të bëjnë kujdes në mbulimin e trupit dhe t'i lënë stolitë gjatë tavafit dhe në raste të tjera ku femrat përzihen me meshkujt; sepse ato janë auret dhe janë tërheqëse. Fytyra e femrës është stolia e saj më e dukshme, prandaj nuk i lejohej ta shfaqë atë, përveçse para mahremëve të saj; për shkak të fjalës së Allahut të Lartësuar:

﴿...وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ...﴾

"...dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre..." (En Nur, 31) Nuk u lejohet atyre të zbulojnë fytyrën gjatë puthjes së Gurit të Zi nëse i shohin burra të huaj. Nëse nuk u krijohet mundësia për ta prekur dhe puthur Gurin, nuk u lejohet të shtyhen me burrat. Përkundrazi, ato duhet të bëjnë tavaf pas tyre, dhe kjo është më e mirë për to dhe marrin shpërblim më të madh sesa tavafi afër Qabes kur shtyhen me burrat. Remli dhe idtibai nuk bëhen vetëm se në këtë tavaf; nuk bëhen gjatë sa'jit, dhe nuk bëhen nga gratë; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) nuk i bëri ato përveçse në tavafin e tij të parë, kur arriti në Mekë. Gjatë tavafit, njeriu duhet të jetë i pastër nga të gjitha papastërtitë dhe i nënshtuar dhe i përlur para Zotit të tij.

Është e pëlqyeshme që gjatë tavafit të shtojë përmendjen e Allahut dhe lutjet, e nëse lexon diçka nga Kurani, kjo është gjë e mirë. Në këtë tavaf, si dhe në tavafet e tjera apo në sa'j, nuk ka dhikër apo lutje specifike të detyrueshme.

Ndërsa sa i përket shpikjes që kanë bërë disa njerëz, duke veçuar çdo xhiro të tavafit apo sa'jit me dhikër të veçantë apo lutje të veçantë, kjo nuk ka bazë. Por mjafton çdo dhikër dhe lutje që i vjen më lehtë. Kur të jetë paralel me këndin jemenas, e prek me dorën e djathtë dhe thotë: "Bismilah, Allahu Ekber", por nuk e puth. Nëse e ka të vështirë ta prekë, e lë dhe vazhdon tavafin e tij; nuk bën me

shenjë drejt tij dhe as nuk merr tekbir kur të jetë paralel me të, sepse kjo nuk është vërtetuar nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!), me aq sa dimë. Është e pëlqyeshme që të thotë ndërmjet këndit jemenas dhe Gurit të Zi:

﴿...رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ 201﴾

“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)!” (El Bekare, 201) Sa herë që kalon pranë Gurit të Zi, e prek dhe e puth, dhe thotë: “Allahu ekber”. E nëse nuk mundet ta prekë dhe ta puthë, bën shenjë drejt tij sa herë që kalon pranë dhe thotë: “Allahu ekber”.

Nuk ka problem që tavafi të bëhet prapa Zemzemit dhe Mekamit, sidomos gjatë dyndjeve. E gjithë Xhamia e Shenjtë është vend për tavaf. Edhe nëse tavafi bëhet nëpër korridoret e xhamisë, kjo është e vlefshme, mirëpo tavafi pranë Qabes është më i mirë, nëse kjo është e mundur.

Pasi të përfundojë tavafin, fal dy rekate pas Mekamit nëse mundet. Nëse nuk mundet, për shkak të turmës së madhe etj, i fal kudo në xhami. Është sunet që në këto dy rekate, pas fatihasë, në rekatin e parë të lexojë suren:

﴿قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ 1﴾

(Kul ja ej-juhel kafirun) (El-Kafirun: 1) dhe suren:

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ 1﴾

(Kul huwallahu ehad) (El Ihlas: 1) në rekatin e dytë; kjo është më e mira, por nuk ka problem edhe nëse lexon diçka tjetër. Pastaj i drejtohet Gurit të Zi dhe e prek me dorën e djathtë, nëse mundet, duke ndjekur kështu shembullin e Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të.

Pastaj del për te kodra e Safasë nga dera e saj; ngjitet mbi të ose qëndron pranë saj. Ngjitja mbi Safa është më e mirë nëse është e mundur. Në fillim të xhiros së parë lexon ajetin:

﴿إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ...﴾

(Kodrinat Safa dhe Merva (në Mekë) janë pjesë e Simboleve të Allahut...) (El Bekareh: 158)

Është e pëlqyeshme të drejtohet nga Kibleja në Safa, të falënderojë e të madhërojë Allahun dhe të thotë: "S'ka të adhuruar (me të drejtë) përveç Allahut, Allahu është më i madhi. S'ka të adhuruar (me të drejtë) përveç Allahut, i Vetëm, pa ortak. Atij i përket pushteti dhe lavdia, Ai jep jetë dhe jep vdekje dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. S'ka të adhuruar (me të drejtë) përveç Allahut, i Vetëm është Ai, e përmbushi premtimin e Tij, e ndihmoi robin e Tij, dhe i mposhti aleatët i Vetëm." Pastaj bën lutje sipas mundësisë, duke i ngritur duart, dhe e përsërit këtë dhikër dhe lutje (tri herë). Më pas zbret dhe ecën drejt Mervasë derisa të arrijë te shenja e parë, ku burri e shpejton ecjen derisa të arrijë te shenja e dytë. Sa i përket gruas, për të nuk

është e ligjësuar ecja e shpejtë midis dy shenjave; përkundrazi, rregulli fetar për të është ecja normale gjatë gjithë sa'jit. Pastaj vazhdon me ecje normale derisa të ngjitet në Merva ose të qëndrojë pranë saj. Por ngjitja në të është më e mirë, nëse kjo është e mundur. Në Merva thotë dhe vepron njësoj si në Safa, me përjashtim të leximit të ajetit:

﴿إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ...﴾

(Kodrinat Safa dhe Merva (në Mekë) janë pjesë e simboleve të Allahut...) (El Bekare: 158) Leximi i tij është i ligjësuar vetëm gjatë ngjitjes në Safa, në xhiron e parë, duke ndjekur shembullin e Profetit (paqja qoftë mbi të!). Pastaj zbret, ecën normalisht aty ku ecet me ecje normale dhe nxiton aty ku duhet të nxitohet, derisa të arrijë në Merva. Kështu vepron shtatë herë; shkuarja është një xhiro më vete dhe kthimi është një xhiro më vete, sepse kështu veproi Profeti (paqja qoftë mbi të!) dhe tha:

«خُذُوا عَلَيَّ مَنَاسِكَكُمْ».

“Merrni (mësoni) prej meje ritet tuaja të Haxhit.”¹ Gjatë sa'jit është i pëlqyeshëm shtimi i përmendjes së Zotit dhe lutjeve sa më shumë që të jetë e mundur, si dhe të qenët i pastër nga papastërtia e madhe dhe e vogël. Nëse dikush e bën sa'jin pa qenë i pastër, ai i llogaritet i vlefshëm. Po ashtu, nëse gruas i vijnë menstruacionet ose lehonja pas tavafit,

¹ Burimi i tij është cekur më lart.

ajo e bën sa'jin dhe ai është i vlefshëm, sepse pastërtia nuk është kusht për sa'jin, por vetëm veprim i pëlqyeshëm, siç u përmend më herët.

Pasi përfundon sa'jin, ai rruan kokën ose i shkurton flokët. Për burrin, rruarja është më e mirë. Nëse i shkurton dhe e lë rruarjen për kohën e Haxhit, kjo është diçka e mirë. Nëse ai mbërrin në Mekë afër kohës së Haxhit, atëherë shkurtimi në rastin e tij është më i mirë, në mënyrë që t'i rruajë flokët e mbetur gjatë Haxhit; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!), kur arriti me shokët e tij në Mekë ditën e katërt të Dhul-Hixhes, i urdhëroi ata që nuk kishin sjellë me vete kafshë për kurban që të liroheshin nga ihrami dhe të shkurtonin flokët, dhe nuk i urdhëroi që t'i rruanin. Në shkurtim është kusht që të përfshihet e gjithë koka dhe nuk mjafton shkurtimi i vetëm një pjese të saj, ashtu siç nuk mjafton as rruarja e vetëm një pjese. Ndërsa për gruan është i ligjësuar vetëm shkurtimi. Rregulli për të është që të shkurtojë nga çdo gërs het sa maja e gishtit të dorës ose më pak. Gruaja nuk duhet të shkurtojë më shumë se kaq.

Pasi personi që është në ihram i kryen veprimet e lartpërmendura, umreja e tij ka përfunduar dhe i lejohet çdo gjë që i ishte ndaluar gjatë ihramit, përveç rastit kur ka sjellë me vete kurbanin, sepse atëherë ai qëndron në ihram derisa të dalë nga ihrami i Haxhit dhe i Umres së bashku.

Ndërsa kush hyn në ihram vetëm për Haxh, ose për Haxh dhe Umre bashkë, është e preferuar për të që ta kthejë ihramin e tij në ihram umreje dhe të veprojë ashtu siç vepron ai që bën temet-tu, përveç nëse ka sjellë me vete kurbanin, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) i urdhëroi shokët e tij të vepronin kështu dhe u tha:

«لَوْلَا أَنِّي سَفَّيْتُ الْهَدْيَ لَأَخَلْتُ مَعَكُمْ» [52].

“Sikur të mos kisha sjellë me vete kurbanin, do të kisha dalë nga ihrami bashkë me ju.” (52)¹

Nëse një gruaje i vjen cikli menstrual ose lehonja pasi ka hyrë në ihram për Umre, ajo nuk bën tavaf rreth Qabes dhe as sa'j mes Safasë dhe Mervasë derisa të pastrohet. Pasi të pastrohet, bën tavafin, sa'jin, i shkurton flokët dhe me këtë e ka përfunduar Umren e saj. Nëse nuk pastrohet para ditës së Tervijes, ajo hyn në ihram për Haxh nga aty ku ndodhet dhe del me njerëzit për në Mina. Me këtë, ajo bëhet "kharine"(bashkuese) duke e bashkuar Haxhin me Umren, dhe i kryen të gjitha ritet që i kryejnë haxhinjtë, si: qëndrimi në Arafat, në Mesh'ar (Muzdelife), hedhja e gurëve, qëndrimi natën në Muzdelife dhe Mina, therja e kurbanit dhe shkurtimi i flokëve. Pasi të pastrohet, bën tavaf rreth Qabesë dhe sa'j mes Safasë dhe Mervasë, një tavaf të vetëm dhe një sa'j të vetëm, dhe kjo i mjafton për Haxhin dhe Umren e saj, për të dyja;

¹ Transmetoi Buhariu nr. 1568.

bazuar në hadithin e Aishes, së cilës i erdhën menstruacionet pasi kishte hyrë në ihram për Umre, dhe Profeti (paqja qoftë mbi të!) i tha:

«افْعَلِي مَا يَفْعَلُ الْحَاجُّ غَيْرَ أَنْ لَا تَطُوفِي بِالْبَيْتِ حَتَّى تَطْهَرِي» [53]

"Bëj atë që bën pelegrini, por mos bëj tavaf rreth Qabesë derisa të pastrohesh!"(53)¹ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Kur gruaja me menstruacione ose gruaja lehonë bën gjuajtjen e guralecëve në ditën e Bajramit dhe i shkurton flokët, asaj i lejohen të gjitha gjërat që i ishin të ndaluara gjatë ihramit, si përdorimi i parfumit etj, përveç marrëdhënieve me burrin, derisa ta plotësojë haxhin e saj si gratë e tjera të pastra. Pasi të bëjë tavafin dhe sa'in pas pastrimit, i lejohen edhe marrëdhëniet me burrin e saj.

KAPITULLI IX:

DISPOZITA E HYRJES NË IHRAM PËR HAXH DITËN E TETË TË DHUL-HIXHXHES DHE DALJES PËR NË MINA

Në ditën e Teurijes, që është dita e tetë e Dhul-hixhxhes, është e pëlqyeshme për ata që ndodhen në Mekë pa ihram dhe për banorët e saj që dëshirojnë të kryejnë Haxhin, që të hyjnë në ihram për haxh prej banesave të tyre; sepse shokët e Profetit (paqja qoftë mbi të!) me urdhrin e tij, qëndruan në Eb'tah dhe hynë në ihram për haxh

¹ Transmetuan Buhariu nr. 305 dhe Muslimi nr. 1211.

prej andej në ditën e Teurijes. Profeti (paqja qoftë mbi të!) nuk i urdhëroi ata të shkonin te Qabja për të hyrë në ihram pranë saj apo pranë Mizabit, e as nuk i urdhëroi për tavafin e lamtumirës kur u nisën për në Mina. Sikur kjo të ishte e ligjësuar, ai do t'ua kishte mësuar atyre atë, dhe e gjithë e mira qëndron në pasimin e Profetit (paqja qoftë mbi të!) dhe shokëve të tij, Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Pëlqehet që të lahet, të pastrohet dhe të parfumoset kur hyn në ihram për haxh, ashtu siç vepron edhe kur hyn në ihram nga miqati. Pasi të hyjnë në ritualet e haxhit, është sunet të nisen për në Mina, në ditën e Tervijes, para ose pas mesditës, dhe të bëjnë sa më shumë Telbije derisa të gjuajnë guralecat te Xhemretul-Akabeja. Në Mina i falin namazet: drekë, ikindi, aksham, jaci dhe sabah. Suneti është që çdo namaz ta falin në kohën e vet, të shkurtuar, por pa i bashkuar, përveç namazit të akshamit dhe të sabahut, të cilët nuk shkurtohen.

Nuk ka dallim mes banorëve të Mekës dhe të tjerëve, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) i priu njerëzve në namaz – banorëve të Mekës dhe të tjerëve – në Mina, Arafat dhe Muzdelife, dhe i fali namazet të shkurtuar. Ai nuk i urdhëroi banorët e Mekës që t'i plotësonin namazet. Nëse kjo do të ishte obligim për ta, ai do t'ua kishte sqaruar.

Pas lindjes së diellit të ditës së Arafatit, haxhinjtë nisen nga Minaja për në Arafat, dhe është sunet të qëndrojnë në Nemira deri në mesditë, nëse kjo

është e mundur; sepse kështu ka vepruar Profeti (paqja qoftë mbi të!).

Pasi të kalojë mesdita, është sunet që imami ose zëvendësi i tij t'u mbajë njerëzve një hutbe që i përshtatet situatës. Në këtë hutbe, ai shpjegon se çfarë është e ligjësuar për haxhinjtë në këtë ditë dhe në ditët në vijim, i porosit për devotshmëri ndaj Allahut, për njësimin e Tij dhe që të jenë të sinqertë ndaj Tij në të gjitha veprat. Gjithashtu, i paralajmëron nga ndalesat e Tij dhe i këshillon t'i përmbahen Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit të Tij (paqja qoftë mbi të!), të gjykojnë me to dhe t'u referohen atyre për gjykim në të gjitha çështjet, duke ndjekur kështu shembullin e Profetit (paqja qoftë mbi të!) në të gjitha këto çështje. Pas hutbes, falen dreka dhe ikindia të shkurtuara dhe të bashkuara në kohën e drekës, me një ezan dhe dy ikamete, sepse kështu veproi Profeti (paqja qoftë mbi të!). Transmeton Muslimi nga hadithi i Xhabirit (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Pastaj njerëzit qëndrojnë në Arafat, i cili i tëri është vendqëndrim, përveç luginës së "Uranetes". Pëlqehet të drejtohet nga kibla dhe nga Kodra e Mëshirës (Xhebelurr-rrahme), nëse kjo është e mundur. Nëse nuk është e mundur të drejtohet nga të dyja, atëherë drejtohet vetëm nga kibla, dhe nuk drejtohet nga kodra. Pëlqehet që haxhiu gjatë këtij qëndrimi t'i përkushtohet me zell dhikrit (përkujtimit të Allahut), lutjes dhe përgjërimit, dhe

t'i ngrejë duart gjatë lutjes. Po ashtu, është mirë të thotë telbijen apo të lexojë diçka nga Kurani. Është sunet të thotë sa më shpesh: "La ilahe il-lall-llahu uahdehu la sherike leh, lehul-mulku ue lehul-hamdu, juhji ue jumi, ue huve ala kul-li shej'in kadir" - "S'ka të adhurar tjetër me të drejtë përveç Allahut, të Vetmit e të Pashok. Atij i takon sundimi dhe lavdia. Ai jep jetë dhe vdekje dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë"; sepse është transmetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«خَيْرُ الدُّعَاءِ دُعَاءُ يَوْمِ عَرَفَةَ، وَأَفْضَلُ مَا قُلْتُ أَنَا وَالنَّبِيُّونَ مِنْ قَبْلِي: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، يُحْيِي وَيُمِيتُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ»

"Lutja më e mirë është lutja e ditës së Arafatit, dhe fjala më e mirë që kam thënë unë dhe profetët para meje është: 'S'ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut, Një dhe i Pashok; Atij i takon sundimi dhe lavdia, Ai jep jetë dhe vdekje, dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë."¹ Është vërtetuar nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«أَحَبُّ الْكَلَامِ إِلَى اللَّهِ أَرْبَعٌ: سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ».

"Fjalët më të mira tek Allahu janë katër: subhanallah (i Lartësuar është Allahu), elhamdulilah (falënderimi i takon Allahut), la ilahe il-lallah (s'ka të adhurar të denjë përveç Allahut) dhe Allahu Ekber (Allahu është më i madhi)."²

¹ Transmetoi Tirmidhiu nr. 3585.

² Transmetoi Muslimi nr. 2137.

Andaj, duhet që ky dhikër të thuhet shpesh dhe të përsëritet me përlësi e me zemër të vëmendshme. Gjithashtu, duhet të thuhet shpesh edhe dhikret dhe lutjet e përcjella në fe, në çdo kohë, sidomos në këtë vend dhe në këtë ditë të madhe. Të zgjedhë dhikret dhe lutjet përmbledhëse, prej të cilave janë:

Subhanallahi ue bihamdihi, Subhanallahil Adhim (I Lartësuar është Allahu dhe Atij i takon lavdërimi, i Lartësuar është Allahu i Madhëruar).

﴿... لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ 87﴾

"La ilahe il-la ente, subhaneke inni kuntu minedh-dhalimin" (S'ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam qenë prej të padrejtëve!) (El Enbija, 87)

"Lā ilāhe il-llAllāhu, ue lā na'budu il-lā ijjāhu, lehun-ni'metu ue lehul-faḍlu ue lehu th-thenā'u l-ḥasenu, lā ilāhe il-llAllāhu muhliṣīne lehud-dīne ue leu kerihel-kāfirūne" (S'ka të adhuroar të denjë përveç Allahut dhe nuk adhurojmë askënd përveç Tij. E Tija është çdo begati, e Tija është çdo mirësi dhe Atij i takon lavdërimi më i mirë. S'ka të adhuroar të denjë përveç Allahut, të sinqertë në adhurimin ndaj Tij, edhe nëse jobesimtarët e urrejnë këtë.)

"La haule ue la kuv-vete il-la bil-lah" (Nuk ka ndryshim dhe as fuqi veçse nëpërmjet Allahut).¹

¹ Transmetoi Muslimi nga Ibën Zubejri, Allahu qoftë i kënaqur me të, nr. 594.

* {...رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ 201}

*"Rabbena atina fid-dunja haseneten ue fi ahirati haseneten ue kina adhaben nar" (Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit të Xhehenemit)!

(El Bekare, 201)

* اللَّهُمَّ أَصْلِحْ لِي دِينِي الَّذِي هُوَ عِصْمَةُ أَمْرِي، وَأَصْلِحْ لِي دُنْيَايَ الَّتِي فِيهَا مَعَاشِي، وَأَصْلِحْ لِي آخِرَتِي الَّتِي فِيهَا مَعَادِي، وَاجْعَلْ الْحَيَاةَ زِيَادَةً لِي فِي كُلِّ خَيْرٍ، وَالْمَوْتَ رَاحَةً لِي مِنْ كُلِّ شَرٍّ.

* "O Allah, ma rregullo fenë time, e cila është mbrojtja e çështjeve të mia; ma rregullo dunjanë time, në të cilën jetoj, dhe ma rregullo botën e përtejme, ku përgjithmonë do të qëndroj! Jetën time ma bëj shkak për shtim të veprave të mira, kurse vdekjen ma bëj rehati nga çdo e keqe!"¹

* أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنْ جَهْدِ الْبَلَاءِ، وَدَرْكِ الشَّقَاءِ، وَسُوءِ الْقَضَاءِ، وَشَمَاتَةِ الْأَعْدَاءِ.

*"Kërkoj mbrojtjen e Allahut nga vështirësia e sprovës së rëndë, nga rënia në mjerim, nga caktimi i keq dhe nga gëzimi i armiqve (për fatkeqësinë time)!"²

* اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْهَمِّ وَالْحَزَنِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْعَجْزِ وَالْكَسَلِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْجُبْنِ وَالْبُخْلِ، وَمِنَ الْمَأْثَمِ وَالْمَغْرَمِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ غَلَبَةِ الدَّيْنِ وَقَهْرِ الرِّجَالِ.

*"O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga pikëllimi dhe mërzia, nga pamundësia dhe përtacia, nga

¹ Transmetoi Muslimi nr. 2720.

² Transmetoi Buhariu nr. 6347, nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të.

frikacakllëku dhe koprracia, nga gjynahu dhe borxhi, nga barra e rëndë e borxhit dhe nga shtypja e njerëzve."¹

* اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْبَرَصِ وَالْجُنُونِ وَالْجُدَامِ وَمِنْ سَيِّئِ الْأَسْقَامِ.

* "O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga sëmundja e lebrës, nga çmenduria, nga murtaja dhe nga sëmundjet e këqija."²

*"O Zoti im, kërkoj nga Ti falje dhe mirëqenie në këtë botë dhe në botën tjetër."

*"O Zoti im, kërkoj që të më falësh dhe të më dhurosh mirëqenie në fenë time, në jetën time, në familjen dhe pasurinë time."

* اللَّهُمَّ اسْتُرْ عَوْرَتِي وَآمِنْ رَوْعَاتِي، اللَّهُمَّ احْفَظْنِي مِنْ بَيْنِ يَدَيْ وَمِنْ خَلْفِي، وَعَنْ يَمِينِي وَعَنْ شِمَالِي، وَمِنْ فَوْقِي، وَأَعُوذُ بِعَظَمَتِكَ أَنْ أُغْتَالَ مِنْ تَحْتِي.

* "O Zoti im, m'i mbulo të metat e mia dhe më qetëso në çastet trishtuese! O Zot, më ruaj nga para dhe prapa, nga e djathta, nga e majta dhe nga lart; kërkoj mbrojtje përmes madhështisë Sate të mos më përpijë Toka!"³

* اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي جَدِّي وَهَزْلِي، وَخَطْبِي وَعَمْدِي، وَكُلَّ ذَلِكَ عِنْدِي، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ وَمَا أَخَّرْتُ، وَمَا أَسْرَرْتُ وَمَا أَعْلَنْتُ، وَمَا أَنْتَ أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي، أَنْتَ الْمُقَدِّمُ وَأَنْتَ الْمُؤَخِّرُ، وَأَنْتَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.

*"O Allah, m'i fal gabimet e bëra me seriozitet dhe me shaka, me vetëdije dhe pavetëdije, se të gjitha

¹ Me këtë tekst e ka transmetuar Ebu Davudi nga Ebu Uname el-Ensari pa pjesën: (ومن المائم والمغرم) nr. 1554.

² Transmetoi Ebu Davudi nr. 1554.

³ Transmetoi Ebu Davudi nga Ibën Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me të dy, nr. 5074.

gjenden tek unë! O Allah, m'i fal mëkatet e kaluara dhe të tashmet, ato që i kam fshehur dhe ato që i kam shfaqur, dhe ato që Ti i di më mirë se unë! Ti vendos përpara kë të duash dhe lë pas kë të duash, Ti ke fuqi për çdo gjë."¹

* اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ النَّبَاتَ فِي الْأَمْرِ وَالْعَزِيمَةَ عَلَى الرُّشْدِ، وَأَسْأَلُكَ شُكْرَ نِعْمَتِكَ وَحُسْنَ عِبَادَتِكَ، وَأَسْأَلُكَ قَلْبًا سَلِيمًا وَلِسَانًا صَادِقًا، وَأَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا تَعْلَمُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا تَعْلَمُ، وَأَسْتَغْفِرُكَ لِمَا تَعْلَمُ، إِنَّكَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ.

* "O Allah, më bëj të qëndrueshëm në fe dhe më jep vendosmëri në udhëzim, të kërkoj të jem mirënjohës për dhuntitë e Tua dhe të të adhuroj në mënyrën më të mirë, të kërkoj një zemër të pastër dhe një gjuhë të sqartë, të kërkoj nga e mira që Ti e di, kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që Ti e di, dhe kërkoj faljen Tënde për atë që Ti e di. Vërtet, Ti je i Gjithëdituri i të fshehtave."²

* اللَّهُمَّ رَبَّ النَّبِيِّ مُحَمَّدٍ عَلَيْهِ الصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ، اغْفِرْ لِي ذَنْبِي، وَأَذْهَبْ عَيْظَ قَلْبِي وَأَجْزِنِي مِنْ مُضَلَّاتِ الْفِتَنِ مَا أَحْبَبْتَ.

* "O Allah, o Zot i pejgamberit Muhamed (paqja dhe bekimet qofshin mbi të!) ma fal mëkatin tim, largoje mllefin nga zemra ime dhe më mbro nga sprovat devijuese për sa kohë të na mbash gjallë!"³

¹ Pjesë nga hadithi i transmetuar nga Muslimi prej Ebu Musa Esh'ariut, Allahu qoftë i kënaqur me të, nr. 2719.

² Transmetoi Tirmidhiu nga Sheddad ibën Eus, Allahu qoftë i kënaqur me të, nr. 3407.

³ Transmetoi Ahmedi nga Ummu Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!) (6/301).

* اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَاوَاتِ وَرَبَّ الْأَرْضِ وَرَبَّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ، رَبَّنَا وَرَبَّ كُلِّ شَيْءٍ، فَالِقَ الْخَبِّ وَالنَّوَى، وَمُنْزِلَ التَّوْرَةِ وَالْإِنْجِيلِ وَالْفُرْقَانِ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ سَرِّ كُلِّ شَيْءٍ أَنْتَ آخِذٌ بِنَاصِيَتِهِ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الْأَوَّلُ فَلَيْسَ قَبْلَكَ شَيْءٌ، وَأَنْتَ الْآخِرُ فَلَيْسَ بَعْدَكَ شَيْءٌ، وَأَنْتَ الظَّاهِرُ فَلَيْسَ فَوْقَكَ شَيْءٌ، وَأَنْتَ الْبَاطِنُ فَلَيْسَ دُونَكَ شَيْءٌ، اقْضْ عَنَّا الدَّيْنَ وَأَغْنِنَا مِنَ الْفَقْرِ.

"O Allah, Zoti i qiejve, Zoti i Tokës dhe Zoti i Arshit të Madh! O Zoti ynë dhe Zoti i gjithçkaje! O Zbërthyes i farës dhe i bërthamës! O Ti që ke zbritur Teuratin, Inxhilin dhe Furkanin (Kuranin)! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e çdo gjëje që Ti e ke nën sundimin Tënd të plotë. O Allah, Ti je i Pari dhe para Teje nuk ka asgjë, Ti je i Fundit dhe pas Teje nuk ka asgjë. Ti je i Dukshmi dhe mbi Ty nuk ka asgjë, Ti je i Fshehti dhe përtej Teje nuk ka asgjë. Na i shlyej borxhet dhe na shpëto nga varfëria!"¹

* اللَّهُمَّ أَعْطِ نَفْسِي تَقْوَاهَا، وَزَكَّاهَا أَنْتَ خَيْرُ مَنْ زَكَّاهَا، أَنْتَ وَلِيُّهَا وَمَوْلَاهَا، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْعَجْزِ وَالْكَسَلِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْجُبْنِ وَالْهَرَمِ وَالْبُخْلِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ.

"O Allah, jepi shpirtit tim devotshmërinë e tij dhe pastroje atë, sepse Ti je më i Miri që e pastron. Ti je Mbrojtësi dhe Zotëruesi i tij. Allahu im, kërkoj mbrojtjen Tënde nga paaftësia dhe përtacia, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga frika, pleqëria e thellë dhe koprracia, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga dënimi i varrit!"²

¹ Transmetoi Muslimi nr. 2713, nga hadithi i Ebi Hurejres, Allahu qoftë i kënaqur me të.

² Transmetoi Muslimi nr. 2722, nga hadithi i Zejd ibn Erkamit, Allahu qoftë i kënaqur me të.

* اللَّهُمَّ لَكَ أَسْلَمْتُ، وَبِكَ أَمَنْتُ، وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ، وَإِلَيْكَ أُنِيتُ، وَبِكَ خَاصَمْتُ، أَعُوذُ بِعِزَّتِكَ أَنْ تُضِلَّنِي، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَنْتَ الْحَيُّ الَّذِي لَا يَمُوتُ، وَالْحَيُّ وَالْإِنْسُ يَمُوتُونَ.

"O Allah, Ty të jam dorëzuar, tek Ti kam besuar, tek Ti jam mbështetur, tek Ti jam kthyer me pendim dhe për Ty kam kundërshtuar. Kërkoj mbrojtje me Madhësitinë Tënde që të mos më lësh të humbas, nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje. Ti je i Gjalli që nuk vdes kurrë, ndërsa xhinët dhe njerëzit vdesin."¹

* اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عِلْمٍ لَا يَنْفَعُ، وَمِنْ قَلْبٍ لَا يَخْشَعُ، وَمِنْ نَفْسٍ لَا تَتَّعِبُ، وَمِنْ دَعْوَةٍ لَا يُسْتَجَابُ لَهَا.

"O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga dituria që nuk bën dobi, nga zemra që nuk ka frikë, nga shpirti që nuk ngopet dhe nga lutja që nuk pranohet."²

* اللَّهُمَّ جَنِّبْنِي مُنْكَرَاتِ الْأَخْلَاقِ وَالْأَعْمَالِ وَالْأَهْوَاءِ وَالْأَدْوَاءِ.

"O Allah, më largo nga moralet e këqija, veprat e këqija, pasionet e këqija dhe sëmundjet e këqija!"³

* اللَّهُمَّ أَلْهِمْنِي رُشْدِي، وَأَعِزَّنِي مِنْ شَرِّ نَفْسِي.

"O Allahu im! Më frymëzo me udhëzim të drejtë dhe më mbro nga e keqja e vetes sime!"⁴

* اللَّهُمَّ اكْفِنِي بِحَلَالِكَ عَنْ حَرَامِكَ، وَأَغْنِنِي بِفَضْلِكَ عَنْ سَوَاكَ.

¹ Transmetoi Muslimi nr. 2717, nga hadithi i Ibën Abbasit, Allahu qoftë i kënaqur me të dy.

² Kjo është pjesë e hadithit të Zejd ibën Erkamit, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili është përmendur më parë me nr. 2722.

³ Transmetoi Tirmidhiu nga Zijad bin Alaka, e ai nga xhaxhai i tij, nr. 3591.

⁴ Transmetoi Tirmidhiu nr. 3483 nga Imran ibën Husejn, Allahu qoftë i kënaqur me të.

* "O Allah, bëj që të më mjaftojë hallalli Yt nga harami Yt, dhe më pasuro me mirësinë Tënde nga çdokush tjetër veç Teje!"¹

* اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْهُدَى وَالتَّقَى وَالعِفَّةَ وَالْغِنَى.

*"O Allah, unë kërkoj prej Teje udhëzimin, devotshmërinë, dëlirësinë dhe vetëmjaftueshmërinë!"²

* اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْهُدَى وَالسَّادَ.

*"O Allah, unë kërkoj prej Teje udhëzimin dhe drejtësinë!"³

* اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنَ الْخَيْرِ كُلِّهِ، عَاجِلِهِ وَآجِلِهِ، مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الشَّرِّ كُلِّهِ، عَاجِلِهِ وَآجِلِهِ، مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ، وَأَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا سَأَلَكَ مِنْهُ عَبْدُكَ وَنَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ ﷺ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا اسْتَعَاذَ مِنْهُ عَبْدُكَ وَنَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ ﷺ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ، وَأَسْأَلُكَ أَنْ تَجْعَلَ كُلَّ قَضَاءٍ قَضَيْتَهُ لِي خَيْرًا.

*"O Allah, kërkoj prej Teje çdo të mirë, atë të menjëhershmen dhe të vonuarën, atë që unë e di dhe atë që unë nuk e di, dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga çdo e keqe, ajo e menjëhershme dhe e vonuara, atë që unë e di dhe atë që unë nuk e di, dhe kërkoj prej Teje çdo të mirë që ta ka kërkuar rob i Profeti Yt, Muhamedi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!), dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga çdo

¹ Transmetoi Tirmidhiu nr. 3563 nga Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të.

² Transmetoi Muslimi nr. 2721, nga hadithi i Abdullah ibën Mesudit, Allahu qoftë i kënaqur me të.

³ Transmetoi Muslimi nga hadithi i Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me të, nr. 2725.

e keqe prej së cilës të ka kërkuar mbrojtje robi dhe Profeti Yt, Muhamedi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!). O Allah, e kërkoj prej Teje Xhenetin dhe çdo gjë që të afron tek ai, qoftë fjalë apo vepër, dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga Zjarri dhe çdo gjë që të afron tek ai, qoftë fjalë apo vepër, dhe të lus që çdo caktim që ke caktuar për mua ta bësh të mirë!"¹.

* لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، يُحْيِي وَيُمِيتُ بِيَدِهِ الْخَيْرُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ.

"La ilahe il-lAllahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul hamdu, juhji ue jumitu, bijedihil khajru ue huve ala kul-li shej'in kadir. Subhanallahi, uel-hamdulil-lahi, ue la ilahe il-lAllahu, vAllahu ekber, ue la haule ue la kuvvete il-la bil-lahil alijjil adhim." - (S'ka të adhuroar të denjë përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdia, Ai jep jetë dhe vdekje, në dorën e Tij është çdo e mirë dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. I lavdëruar qoftë Allahu, falënderimi i takon Allahut, s'ka të adhuroar të denjë përveç Allahut, Allahu është më i Madhi, dhe s'ka ndryshim e as fuqi, përveçse me Allahun, të Lartin, Madhështorin).²

¹ Transmetoi Ibn Maxheh nr. 3846 nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të).

² Transmetoi Buhariu nr. 1154, nga hadithi i Ubade ibën es-Samitit, Allahu qoftë i kënaqur me të.

* اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ، وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ، وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ، وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ، وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ، وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ.

"All-llāhumme şal-li 'alā Muḥam-medin ue 'alā āli Muḥam-medin, kemā şal-lejte 'alā Ibrāhīme ue alā āli Ibrāhīme, in-neke Ḥamīdum Mexhīd. Ue bārik alā Muḥam-medin ue alā āli Muḥam-medin, kemā bārakte alā Ibrāhīme ue alā āli Ibrāhīme, in-neke Ḥamīdum Mexhīd." (O Allah, lavdëroje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit ashtu siç lavdërove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar. O Allah, begatoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar.)¹

* (رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ 201)

*"Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)!"

(El Bekare, 201)

Është e pëlqyeshme që në këtë vendqëndrim madhështor haxhiu t'i përsërisë dhikret dhe lutjet e lartpërmendura, si dhe çdo dhikër, lutje dhe salavatë mbi Profetin (paqja qoftë mbi të!) që ka kuptim të ngjashëm me ato. Të këmbëngulë në lutje dhe t'i kërkojë Zotit të tij të mirat e kësaj bote dhe

¹ Transmetoi Buhariu nr. 3370, nga hadithi i Ka'b ibn Uxhras, Allahu qoftë i kënaqur me të.

të botës tjetër. Profeti (paqja qoftë mbi të!), kur lutej, e përsëriste lutjen tri herë, andaj duhet pasuar shembulli i tij në këtë çështje.

Në këtë vendqëndrim, muslimani duhet të qëndrojë i përlur para Zotit të tij, modest dhe i nënshtruar para Madhërisë së Tij, i përvuajtur dhe i përkulur para Tij, duke shpresuar mëshirën dhe faljen e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit dhe zemërimit të Tij. E merr veten në llogari dhe bën pendim të sinqertë, sepse kjo është një ditë e madhe dhe një tubim madhështor, ku Allahu tregon bujarinë e Tij ndaj robërve të Tij, krenohet me ta para engjëjve të Tij dhe liron shumë prej tyre nga Zjarri. Nuk është parë shejtani në ndonjë ditë tjetër më i mposhtur, më i vogël dhe më i poshtëruar se në Ditën e Arafatit, përveç Ditës së Bedrit; dhe kjo për shkak të asaj që ai sheh nga bujaria e Allahut ndaj robërve të Tij, mirësisë së Tij ndaj tyre, dhe lirimit e faljes së Tij të shumtë.

Në Sahihun e Muslimit, Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَا مِنْ يَوْمٍ أَكْثَرَ مِنْ أَنْ يُعْتَقَ اللَّهُ فِيهِ عَبْدًا مِنَ النَّارِ مِنْ يَوْمِ عَرَفَةَ، وَإِنَّهُ لَيُنْذَوُ ثُمَّ يُبَاهِي بِهِمُ الْمَلَائِكَةَ، فَيَقُولُ: مَا أَرَادَ هَؤُلَاءِ؟».

“Nuk ka ditë në të cilën Allahu liron më shumë robër nga Zjarri sesa Dita e Arafatit. Ai me të vërtetë

afrohet, pastaj krenohet me ta para melekëve dhe thotë: Çfarë duan këta?"¹

Prandaj, u takon muslimanëve t'i tregojnë Allahut më të mirën nga vetja e tyre, ta poshtërojnë armikun e tyre, djallin, dhe ta dëshpërojnë atë me lëvdim e madhërim të shumtë të Allahut, me lutje, me pendim të vazhdueshëm dhe kërkim faljeje për të gjitha mëkatet dhe gabimet. Haxhilerët vazhdojnë të qëndrojnë në këtë vend të angazhuar me përmendjen e Allahut, me lutje dhe përgjërime derisa të perëndojë dielli. Pasi të perëndojë dielli, ata nisen për në Muzdelife me qetësi e dinjitet, duke e shtuar Telbijen dhe duke e shpejtuar ecjen në vendet e gjera, sepse kështu ka vepruar Profeti (paqja qoftë mbi të!). Nuk lejohet largimi para perëndimit të diellit, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka qëndruar derisa ka perënduar dielli dhe ka thënë:

«خُذُوا عَلَيَّ مَنَاسِكُكُمْ».

“Merrni prej meje ritet tuaja të haxhit!”²

Kur të mbërrijnë në Muzdelife, e falin atje akshamin me tre rekate dhe jacinë me dy rekate, të bashkuara, me një ezan dhe dy ikamete, sapo të mbërrijnë atje; sepse kështu ka vepruar Profeti (paqja qoftë mbi të!), pavarësisht nëse mbërrijnë në

¹ Transmetoi Muslimi nr. 1348 nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të).

² Burimi i tij është cekur më lart.

Muzdelife në kohën e akshamit apo pasi të ketë hyrë koha e jacisë.

Sa i përket veprimit të disa njerëzve të thjeshtë, të cilët i mbledhin guralecët e Xhemresë sapo arrijnë në Muzdelife, para se të falen, dhe besimit të shumë prej tyre se kjo gjë është e ligjësuar, kjo është gabim dhe e pabazë. Profeti (paqja qoftë mbi të!) nuk ka urdhëruar që t'i mblidhen guralecët për të, përveçse pas largimit të tij nga Mesh'ari (Muzdelifeja) për në Mina. Prej cilitdo vend që t'i mbledhë guralecët, konsiderohet e vlefshme dhe nuk është e thënë që ato të mblidhen patjetër nga Muzdelifeja, por lejohet mbledhja e tyre edhe nga Minaja. Suneti është që në këtë ditë të mblidhen shtatë guralecë, dhe me to gjuan Xhemretul-Akabenë, duke ndjekur shembullin e Profetit (paqja qoftë mbi të!). Ndërsa në tri ditët vijuese, mblidhen nga Minaja çdo ditë nga njëzet e një guralecë dhe me to gjuan të tri Xhemeratet.

Nuk është e pëlqyeshme larja e guralecëve, por ato hidhen pa u larë; sepse kjo nuk është transmetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) dhe sahabët e tij, dhe nuk gjuhet me guralecë të hedhur më parë.

Haxhiu e kalon këtë natë në Muzdelife. U lejohet të dobëtohet, si grave dhe fëmijëve, të largohen për në Mina në fund të natës, për shkak të hadithit që transmetohet nga Aishja, Ummu Selemeja, etj. Ndërsa për haxhinjtë e tjerë, është e theksuar që të

qëndrojnë aty derisa ta falin namazin e sabahut, pastaj të ndalen te Mesh'ari i Shenjtë, të drejtohen nga Kibla dhe të shtojnë përkujtimin e Allahut, tekbiret dhe lutjet, derisa të zbardhë mirë. Pëlqehet ngritja e duarve këtu gjatë lutjes. Kudo që të qëndrojnë haxhinjtë në vendin e Muzdelifes, u mjafton, dhe nuk e kanë obligim të afrohen pranë Mesh'arit e as të ngjiten në të, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«وَقَفْتُ هَاهُنَا - يَعْنِي عَلَى الْمَشْعَرِ الْحَرَامِ - وَجَمَعَ كُلُّهَا مَوْقِفٌ»

"Unë qëndrova këtu - d.m.th. në Mesh'aril Haram - e megjithatë e gjithë Muzdelifeja është vendqëndrim."¹ E ka transmetuar Muslimi në "Sahihun" e tij. Fjala "Xhem'un" e përdorur në këtë hadith nënkupton Muzdelifenë.

Pasi të ketë zbardhur mirë dita, nisen drejt Minasë para lindjes së diellit dhe gjatë rrugës e shtojnë Telbijen. Kur arrijnë në Muhassir, është e pëlqyeshme t'i shpejtojnë pak hapat.

Kur të arrijnë në Mina, e ndërpresin telbijen te Xhemretul-Akabe, dhe hedhin guralecët sapo të mbërrijnë, shtatë guralecë njëri pas tjetrit, duke e ngritur dorën dhe duke thënë 'Allahu Ekber' me çdo gjuajtje. Është e pëlqyeshme që gjuajtja të bëhet nga fundi i luginës, duke e lënë Qabenë në anën e majtë dhe Minanë në anën e djathtë, sepse kështu ka

¹ Transmetoi Muslimi nr. 1218, nga hadithi i Xhabirit (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

vepruar Profeti (paqja qoftë mbi të!). Nëse gjuajtja bëhet nga anët e tjera, ajo është e vlefshme me kusht që guralecët të biejnë në vendin e caktuar. Nuk është kusht që guraleci të mbetet në vendin e hedhjes, por vetëm që të bjerë brenda tij. Prandaj, nëse guraleci bie në vendin e hedhjes dhe pastaj del prej andej, gjuajtja konsiderohet e vlefshme sipas medimit të njohur të dijetarëve. Prej atyre që e kanë pohuar këtë është edhe Neveviu (Allahu e mëshiroftë!) në veprën e tij 'Sherh el-Muhedh-dheb'. Guralecët e Xhemerateve duhet të jenë të vegjël, pak më të mëdhenj se qiqrat.

Pastaj, pas hedhjes së gurëve, ther kurbanin e tij. Është e pëlqyeshme që gjatë therjes të thotë: "Bismil-lahi vall-llahu ekber, Allahumme hadha minke ue leke" (Në emër të Allahut, Allahu është më i madhi! O Zot, kjo është prej Teje dhe për Ty!) dhe ta kthejë kurbanin nga Kibla. Suneti është që devetë të theren në këmbë, me këmbën e majtë të lidhur, ndërsa lopët dhe delet të theren të shtrira në anën e majtë. Nëse e ther kurbanin pa e kthyer nga Kibla, ka lënë një sunet, por kurbanin e tij është i vlefshëm, sepse kthimi nga kibla gjatë therjes është sunet dhe jo obligim. Është e pëlqyeshme që të hajë nga kurbanin e tij, të dhurojë dhe të japë lëmoshë, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿...فَكُلُوا مِنْهَا وَأَطْعُمُوا الْبَائِسَ الْفَقِيرَ﴾

"Hani nga ato (mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër!" (El Haxh, 28) Koha e therjes së kurbanit zgjat deri në perëndimin e diellit të ditës së tretë të ditëve të teshrikut, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve. Pra, koha e therjes është dita e Kurban Bajramit dhe tri ditë pas saj.

Më pas, pas therjes së kurbanit, rruan kokën ose i shkurton flokët, por rruajtja është më e mirë; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) është lutur për mëshirë dhe falje për ata që rruajnë kokën (tri herë) dhe për ata që i shkurtojnë flokët vetëm një herë. Nuk mjafton shkurtimi i një pjese të kokës, por duhet që shkurtimi të përfshijë gjithë kokën, ashtu si rruajtja. Ndërsa gruaja shkurton nga çdo gërshet sa maja e gishtit, ose më pak.

Pas hedhjes së gurëve në Xhemren e Akabesë dhe rruajtjes ose shkurtimit të flokëve, haxhiut i lejohen të gjitha gjërat që i kishte të ndaluara gjatë ihramit, përveç marrëdhënieve bashkëshortore. Ky lirim quhet: lirimi i parë. Pas këtij lirimi, është e preferuar që ai të parfumoset dhe të drejtohet për në Mekë, për të bërë tavafin e Ifades, sipas hadithit të Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e cila ka thënë:

«كُنْتُ أَطِيبُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ لِإِحْرَامِهِ قَبْلَ أَنْ يُحْرِمَ، وَلِحَالِهِ قَبْلَ أَنْ يَطُوفَ بِالْبَيْتِ»

"Unë e parfumosja të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!) për ihramin e tij para se të hynte në

të, dhe për lirimin nga ihrami para se të bënte tavafin e Qabesë.”¹ E shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Ky tavaf quhet: Tavafi i Ifadës dhe Tavafi i Zijares. Ai është një nga shtyllat e Haxhit dhe Haxhi nuk është i vlefshëm pa të, dhe ai nënkuptohet në fjalën e Allahut të Madhërishëm:

﴿ثُمَّ لْيَقْضُوا تَفَثَهُمْ وَلْيُوفُوا نُذُورَهُمْ وَلْيَطَّوَّفُوا بِالْبَيْتِ الْعَتِيقِ﴾ (29)

"Pastaj, haxhinjtë le të pastrojnë trupin e tyre, le t'i kryejnë zotimet e tyre dhe le t'i vijnë rrotull Shtëpisë së lashtë." (El Haxh, 29)

Pastaj, pas tavafit dhe faljes së dy rekateve prapa mekemit, bën sa'jin mes Safasë dhe Mervasë, nëse është duke bërë Haxhin e Temettuit; ky sa'j është për haxhin, ndërsa sa'ji i parë ishte për umren.

Dhe nuk mjafton një sa'j i vetëm, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve; bazuar në hadithin e Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), e cila ka thënë: "Ne u nisëm me të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!)..." - pastaj e përmendi hadithin, ku Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) tha:

«وَمَنْ كَانَ مَعَهُ هَدْيٌ فَلْيُهِلَّ بِالْحَجِّ مَعَ الْعُمْرَةِ ثُمَّ لَا يَجُلْ حَتَّى يَجُلَ مِنْهُمَا جَمِيعًا»...

"Kush ka me vete kurban, le të bëjë nijetin për haxh bashkë me umren, pastaj të mos dalë nga ihrami derisa t'i përfundojë të dyja së bashku!... Deri tek fjala e saj:

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1539 dhe Muslimi nr. 1189.

«قَطَّافَ الَّذِينَ أَهَلُّوا بِالْعُمْرَةِ بِالْبَيْتِ وَالصَّفَا وَالْمَرْوَةِ ثُمَّ حَلُّوا ثُمَّ طَافُوا طَوَافًا
آخَرَ بَعْدَ أَنْ رَجَعُوا مِنْ مَنَى لِحَجَّتِهِمْ»

Ata që kishin bërë nijet për umre, bënë tavaf rreth Qabesë dhe mes Safasë e Mervasë, pastaj dolën nga ihrami. Më pas bënë një tavaf tjetër, pasi u kthyen nga Minaja, për haxhin e tyre."¹ Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Sa i përket fjalës së saj (Allahu qoftë i kënaqur me të!) për ata që kishin nisur Umren: "Pastaj bënë një tavaf tjetër për haxhin e tyre pasi u kthyen nga Minaja", me këtë ka për qëllim ecjen mes Safasë dhe Mervasë, sipas mendimit më të saktë në shpjegimin e këtij hadithi. Ndërsa mendimi i atyre që thonë se ajo kishte për qëllim tavafin e Ifadas, nuk është i saktë, sepse tavafi i Ifadas është shtyllë për të gjithë pelegrinët dhe ata tashmë e kishin kryer atë. Por, me këtë është për qëllim vetëm ecja e haxhiut të llojit "mutemet-ti" mes Safasë dhe Mervasë për herë të dytë pas kthimit nga Minaja, për të plotësuar haxhin e tij. Kjo gjë, falënderimi i qoftë Allahut, është e qartë dhe ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

Për vërtetësinë e kësaj dëshmon edhe transmetimi që e përcjell Buhariu në Sahihun e tij pa zinxhirë të plotë, por në formë të sigurtë, nga Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!), se ai u pyet për llojin e haxhit temet-tu, dhe tha:

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1556 dhe Muslimi nr. 1211.

"Muhaxhirët, ensarët dhe gratë e Profetit (paqja qoftë mbi të!) hynë në ihram në Haxhin e Lamtumurës, e po ashtu u futëm në ihram edhe ne. Kur arritëm në Mekë, i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) tha: "Ihramin tuaj të haxhit bëjeni për umre, përveç atij që ka sjellë me vete kurbanin!" Kështu, ne bëmë tavaf rreth Qabes dhe mes Safasë e Mervasë, fjetëm me bashkëshortet dhe veshëm rrobat e zakonshme. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) tha: "Kushdo që ka sjellë me vete kurbanin, nuk del nga ihrami derisa kurbanin të arrijë në vendin e therjes." Pastaj, në mbrëmjen e ditës së Tervijes, na urdhëroi që të bënim ihram për haxh, dhe kur t'i përfundonim ritualet, të vinim e të bënim tavaf rreth Qabes dhe mes Safasë e Mervasë."¹ Këtu përfundoi pjesa që na intereson nga ky hadith, dhe kjo është dëshmi e qartë për saj-in e dyfishtë që bën ai që kryen haxhin temet-tu. Allahu është më i Dijshmi.

Sa i përket asaj që e shënon Muslimi nga Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se: "Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) dhe sahabët e tij bënë vetëm një tavaf (ecje) mes Safasë dhe Mervasë"², bëhet fjalë për tavafin (ecjen) e tyre të parë dhe kjo i referohet atyre sahabëve që kishin sjellë me vete kurbanin, sepse ata mbetën në ihramin e tyre me

¹ Shënon Buhariu, nr. 1572.

² Transmetoi Muslimi nr. 1215.

Profetin ((paqja qoftë mbi të!) derisa dolën nga ihrami i Haxhit dhe i Umres së bashku. Profeti ((paqja qoftë mbi të!) kishte bërë nijet për Haxh dhe Umre dhe i urdhëroi ata që kishin sjellë kurbanin me vete që të bënin nijet për Haxh bashkë me Umren dhe që të mos dilnin nga ihrami derisa t'i përfundonin të dyja bashkë. Kurse ai që i bashkon Haxhin me Umren, nuk ka për detyrë veçse një sa'j (ecje midis Safasë dhe Mervasë) të vetëm, siç dëshmon hadithi i lartpërmendur i Xhabirit dhe hadithe të tjera të sakta.

Po kështu, ai që bën Haxhin e Ifradit dhe qëndron në ihram deri në ditën e Bajramit, ka për detyrë vetëm një sa'j. Nëse ai që bën Haxh e Kiranit dhe ai që bën Haxhin e Ifradit e bëjnë sa'jin pas tavafit të mbërritjes, kjo u mjafton dhe nuk u kërkohet sa'j pas tavafit të ifadës. Kështu bëhet pajtimi mes haditheve të Aishes dhe Ibën Abasit dhe hadithit të lartpërmendur të Xhabirit. Dhe kështu, largohet kundërshtia midis tyre dhe bëhet i mundur zbatimi i të gjitha haditheve.

Ajo që e përkrah këtë pajtim është se hadithet e Aishes dhe Ibën Abasit janë të dy hadithe të sakta, dhe të dy e pohojnë sajën e dytë për atë që bën haxhin e temet-tuit, ndërsa kuptimi i dukshëm i hadithit të Xhabirit e mohon këtë. Në këtë rast argumenti pohues ka përparësi ndaj atij mohues, sikurse është e përcaktuar në shkencën e parimeve të jurisprudencës dhe terminologjisë së hadithit.

Allahu i Lartësuar udhëzon te e drejta, dhe nuk ka fuqi as forcë përveçse me Allahun.

KAPITULLI X:

SQARIMI RRETH PËRPARËSISË SË VEPRAVE TË HAXHIUT NË DITËN E KURBANIT

Më e preferuara për haxhiun është që t'i radhisë këto katër veprime ditën e Bajramit siç vijon: fillimisht hedhja e gurëve në Xhemretul-Akabeh, pastaj therja e kurbanit, pastaj rruajtja ose shkurtimi i flokëve, dhe më pas tavafi dhe sa'ji pas tij për atë që bën Haxhin e Temet-tuit, si dhe për atë që bën Haxhin e Ifradit dhe Kiranit, nëse nuk e kanë bërë sa'jin bashkë me tavafin e mbërritjes. Nëse e ndryshon radhën e këtyre veprimeve, kjo i lejohet, sepse kjo gjë është vërtetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) në formë lehtësimi. Në këtë lehtësim përfshihet edhe bërja e sa'jit para tavafit, sepse kjo është një nga veprimet që kryhen ditën e Bajramit, dhe përfshihet në thënien e sahabiut: "Atë ditë, për çdo gjë që u pyet, nëse ishte bërë para apo pas kohës së saj, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) tha:

«افْعَلْ وَلَا حَرَجَ» [84]

"Bëje, nuk ka problem."(84)¹ Po ashtu, meqenëse në raste të tilla mund të ketë harresë dhe mungesë dije, andaj është e domosdoshme që edhe kjo të

¹ Transmetuan Buhariu nr. 83 dhe Muslimi nr. 1306.

përfshihet në këtë parim të përgjithshëm, për shkak të lehtësimit.

Është e vërtetuar se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) është pyetur për dikë që e bëri sa'jin para tavafit, dhe ka thënë:

«لَا حَرَجَ»

"S'ka gjë!"¹ E shënon Ebu Davudi, nga Usame bin Sheriku, me zinxhir të saktë të transmetuesve. Kështu, bëhet e qartë pa dyshim përfshirja e tij në rregullin e përgjithshëm. Udhëzimi është në Dorën e Allahut.

Lirimi i plotë nga ihrami për haxhiun arrihet me anë të tri veprimeve: hedhja e guralecëve në Xhemretul-Akabe, rruajtja ose shkurtimi i flokëve dhe tavafi i Ifadës bashkë me sa'jin pas tij. Pasi t'i kryejë këto tri veprime, atij i lejohet gjithçka që e kishte të ndaluar gjatë ihramit, si marrëdhëniet bashkëshortore, parfumosja etj. Ndërsa kush kryen vetëm dy prej këtyre tri veprimeve, i lejohet gjithçka që e kishte të ndaluar gjatë ihramit, përveç marrëdhënieve bashkëshortore dhe kjo quhet: lirimi i parë nga ihrami.

Është e pëlqyer për haxhiun të pijë ujë Zemzemi derisa të ngopet, dhe të bëjë nga lutje e dobishme që di. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَاءُ زَمْزَمَ لِمَا شَرِبَ لَهُ».

¹ Transmetoi Ebu Davudi nr. 2015.

“Uji i Zemzemit është për atë (qëllim) që pihet.”¹ Po ashtu transmetohet në "Sahihun" e Muslimit nga Ebu Dherri se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë për ujin e Zemzemit:

«إِنَّهُ طَعَامٌ طُعْمٌ».

“Ai është ushqyes.”² Ebu Davudi ka shtuar:

«وَسِقَاءٌ سُقْمٌ» [88].

“Dhe shërim për sëmundjen.” (88)³

Pas kryerjes së tavafit të Ifades dhe s'ajit (për ata që e ka obligim sa'jin), haxhilerët kthehen në Mina, ku qëndrojnë tri ditë e tri netë. Në secilën prej këtyre tri ditëve, ata i gjuajnë të tre Xhemeratet pas mesditës, dhe është obligim që gjuajtja e tyre të bëhet sipas radhës.

E nis me Xhemren e Parë, e cila ndodhet pas xhamisë së Hajfit, dhe i hedh shtatë guralecat njëri pas tjetrit, duke e ngritur dorën në çdo hedhje. Sipas sunetit, që të largohet pak prej saj, ta lërë në anën e majtë, të drejtohet kah Kibla, t'i ngrejë duart dhe të bëjë sa më shumë dua dhe përgjërime.

Pastaj hedh guralecat në Xhemren e Dytë si në të parën, dhe pas hedhjes është sunet të ecë pak

¹ Transmetoi Ibën Maxheja nr. 3062, nga Xhabir bin Abdullahut (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

² Transmetoi Muslimi nr. 2473.

³ D.m.th. Ebu Davud Et-Tajalisiu, i cili e ka transmetuar në të njëjtin hadith ku flitet për pranimin e Islamit nga Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Shih: Musnedi i Ebu Davud Et-Tajalisiut, nr. 459.

përpara, ta lërë atë në anën e djathtë, të drejtohet kah Kibla, të ngrejë duart dhe të lutet gjatë.

Pastaj hedh guralectat në Xhemren e Tretë dhe nuk ndalet pranë saj.

Pastaj, në ditën e dytë të Teshrikut, i hedh guralectat pas mesditës, njësoj si në ditën e parë; tek Xhemreja e Parë dhe e Dytë vepron ashtu siç veproi ditën e parë, duke ndjekur shembullin e Profetit (paqja qoftë mbi të!).

Hedhja e gurëve në dy ditët e para të Teshrikut është obligim prej obligimeve të Haxhit, po ashtu edhe fjetja në Mina natën e parë dhe të dytë është obligim, përveç për shpërndarësit e ujit, barinjtë dhe atyre që janë si ata, për këta nuk është obligim.

Pastaj, pas hedhjes së gurëve në dy ditët e lartpërmendura, kush dëshiron ta përshejtojë largimin nga Minaja, i lejohet kjo gjë dhe duhet të largohet para perëndimit të diellit. Ndërsa kush qëndron, e kalon natën e tretë dhe i hedh guralectat në ditën e tretë. Qëndrimi është më i mirë dhe ka shpërblim më të madh, sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَاذْكُرُوا اللَّهَ فِي أَيَّامٍ مَعْدُودَاتٍ فَمَنْ تَعَجَّلَ فِي يَوْمَيْنِ فَلَا إِنَّهُ عَلَيْهِ وَمَنْ تَأَخَّرَ فَلَا
إِنَّهُ عَلَيْهِ لَمِنَ الْتَقَى...﴾

"Dhe madhëroni Allahun në (tri) ditët e caktuara (të Teshrikut). Por, edhe ata që nguten dhe rrinë vetëm dy ditë (në Mina), nuk bëjnë gjynah; nuk bën gjynah as ai që rri më shumë, nëse i frikësohet

vërtet Allahut..." (El Bekare, 203) Dhe sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) ua lejoi njerëzve të përshpejtonin, por ai vetë nuk u përshpejtua, përkundrazi qëndroi në Mina derisa i hodhi gurët në ditën e 13-të pas mesditës, pastaj u largua para se të falte namazin e drekës.

Gjithashtu, i lejohet kujdestarit të fëmijës që është i paaftë për t'i hedhur vetë gurët, që t'i hedhë ai për të në Xhemretul-Akabe dhe në xhemeratet e tjera, pasi t'i ketë hedhur për veten. Po kështu, për vajzën e vogël që është e paaftë për t'i hedhur gurët, i hedh ato kujdestari i saj, bazuar në hadithin e Xhabirit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ka thënë:

«حَجَّجْنَا مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ، وَمَعَنَا النِّسَاءُ وَالصِّبْيَانُ، فَلَبَّيْنَا عَنِ الصِّبْيَانِ وَرَمَيْنَا عَنْهُمْ» [89]

"Kryem haxhin me të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!), e me ne ishin gratë dhe fëmijët, ne e bëmë telbijen për fëmijët dhe gjuajtëm për ta."(89)¹
Citoi Ibën Maxheja.

Të paaftit për të hedhur gurët për shkak të sëmundjes, moshës së shtyrë ose shtatzënisë, i lejohet të caktojë dikë që t'i hedhë ato në vend të tij; bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar:

(فَاتَّقُوا اللَّهَ مَا اسْتَطَعْتُمْ...)

¹ Transmetoi Tirmidhiu nr. 927.

"Frikësojuni Allahut sa të mundeni...!" (Et Tegabun, 16) Këta njerëz nuk kanë mundësi të shtyhen me turmën të Xhemeratet, ndërkohë koha e gjuajtjes u kalon dhe nuk është e ligjësuar për ta që ta kompensojnë atë. Për këtë arsye, u është lejuar që të autorizojnë dikë tjetër për ta kryer këtë rit, ndryshe nga ritet e tjera. Kështu që, nuk i takon atij që do të hyjë në ihram të caktojë dikë tjetër për ta kryer ritin e ihramit të haxhit ose të umres për të, edhe nëse bëhet fjalë për haxh apo umre vullnetare (nafile), sepse kushdo që hyn në ihram për haxh ose umre, qofshin këto edhe vullnetare, e ka obligim t'i çojë deri në fund ato, në bazë të fjalës së Allahut të Lartësuar:

﴿وَأَتِمُوا الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ لِلَّهِ...﴾

"Plotësojeni haxhin dhe umren për hir të Allahut...!" (El Bekare, 196) Koha e tavafit dhe e sa'jit nuk kalon, ndryshe nga koha e hedhjes së gurëve.

Ndërsa për qëndrimin në Arafat dhe bujtjen në Muzdelife e Mina, nuk ka dyshim se koha e tyre kalon (është e kufizuar), mirëpo prania e të paftëve në këto vende është e mundur, qoftë edhe me vështirësi, ndryshe nga kryerja e drejtpërdrejtë e hedhjes së guralecëve (e cila është e pamundur për ta). Ndryshe nga ritet e tjera, për hedhjen e gurëve është transmetuar nga brezat e parë se e

konsideronin të lejuar përfaqësimin në hedhjen e tyre.

Adhurimet janë të përcaktuara (nga Sheriati) dhe askujt nuk i lejohet të ligjësojë diçka prej tyre, përveçse me argument. I lejohet përfaqësuesit që t'i hedhë gurët për veten e tij e pastaj për atë që e ka autorizuar atë në secilën prej tri xhemerateve, duke qëndruar në të njëjtin vend. Nuk e ka obligim që të përfundojë hedhjen e gurëve në të tri xhemeratet për veten e tij e pastaj të kthehet për t'i hedhur për atë që e ka autorizuar, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve; kjo për shkak të mungesës së argumentit që e obligon një gjë të tillë, si dhe për shkak të vështirësisë dhe mundimit. Allahu i Lartësuar thotë:

{...وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُم فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ...}

"...nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj..." (El Haxh, 78) Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«يَسِّرُوا وَلَا تُعَسِّرُوا» [90].

"Lehtësoni e mos vështirësoni!" (90)¹ Dhe sepse se një gjë e tillë nuk është transmetuar nga shokët e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të!) kur ata gjuajtën gurët në emër të fëmijëve dhe të paaftëve prej njerëzve të tyre. Sikur ta kishin bërë këtë, do të ishte transmetuar, sepse kjo është prej atyre

¹ Transmetoi Buhariu nr. 69, nga hadithi i Enesit, Allahu qoftë i kënaqur me të.

çështjeve për transmetimin e të cilave ka interesim të madh nga njerëzit. E Allahu është më i Dijshmi.

KAPITULLI XI:

OBLIGUESHMËRA E KURBANIT PËR MUTEMET-TIUN DHE KARININ

Haxhiu që është duke bërë ritin e Temet-tuit ose të Kiranit dhe nuk është prej banorëve të Xhamisë së Shenjtë - e ka obligim të therë një kurban, që është: një dele, ose të marrë pjesë në një të shtatën e devesë, ose një të shtatën e lopës. Ky kurban duhet të jetë nga pasuria e lejuar dhe fitimi i pastër, sepse Allahu i Lartësuar është i pastër dhe pranon vetëm atë që është e pastër.

Myslimani që Allahu i ka dhënë pasuri të mjaftueshme për të bërë kurban dhe për të qenë i pavarur nga njerëzit duhet ta ruaj veten e tij dhe të mos lypë prej tyre, as kurban e as ndonjë gjë tjetër, pavarësisht nëse bëhet fjalë për mbretër apo njerëz të tjerë; kjo për shkak të haditheve të shumta nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) që e qortojnë dhe e kritikojnë lypjen, dhe që lavdërojnë atë që i ruhet asaj.

Nëse haxhiu që kryen haxhin Temet-tu dhe Kiran nuk ka mundësi të therë kurban, ai është i detyruar të agjërojë tri ditë gjatë haxhit dhe shtatë ditë kur të kthehet te familja e tij. Ai ka të drejtë të zgjedhë për agjërimin e tri ditëve: nëse dëshiron, i agjëron para ditës së Kurbanit, dhe nëse dëshiron, i agjëron

gjatë tri ditëve të Teshrikut. Në lidhje me këtë, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿...فَمَنْ تَمَتَّعَ بِالْعُمْرَةِ إِلَى الْحَجِّ فَمَا اسْتَيْسَرَ مِنَ الْهَدْيِ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ فَصِيَامَ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ فِي الْحَجِّ وَسَبْعَةٍ إِذَا رَجَعْتُمْ تِلْكَ عَشْرَةٌ كَامِلَةٌ ذَلِكَ لِمَنْ لَمْ يَكُنْ أَهْلَهُ حَاضِرِي الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ...﴾

"...ai që prej jush kryen umren për të kryer më pas edhe haxhin, le të therë një kurban sipas mundësisë. Ndërsa ai që nuk ka mundësi, është i detyruar të agjërojë tri ditë në haxh dhe shtatë ditë pas kthimit nga haxhi; këto janë dhjetë ditë të plota. Kjo është për ata që nuk banojnë në Mekë." (El Bekare, 196) Mbaroi citimi i ajetit.

Në Sahihun e Buhariut ceket se Aishja dhe Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) kanë thënë:

«لَمْ يُرَخَّصْ فِي أَيَّامِ التَّشْرِيقِ أَنْ يُصُومَ إِلَّا لِمَنْ لَمْ يَجِدِ الْهَدْيَ» [91],

"Nuk është lejuar të agjërohet në ditët e Teshrikut, përveç atij që nuk gjen kurban." (91)¹ Kjo konsiderohet si një thënie e Profetit (paqja qoftë mbi të!). Më e mira është që agjërimi i tri ditëve të bëhet para ditës së Arafatit, në mënyrë që personi të mos jetë agjërueshëm në ditën e Arafatit, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) qëndroi në ditën e Arafatit pa qenë agjërueshëm dhe e ka ndaluar agjërimin e ditës së Arafatit për atë që është në Arafat (gjatë haxhit). Po ashtu, mosmbajtja e agjërimit në këtë ditë e bën njeriun më energjik për përmendjen e Allahut (dhikër) dhe për lutje (dua).

¹ Transmetoi Buhariu nr. 1998.

Lejohet që tri ditët e lartpërmendura të agjërohen radhazi ose të ndara. Gjithashtu, edhe për agjërimin e shtatë ditëve nuk është obligim që të agjërohen radhazi, por lejohet të agjërohen bashkë (radhazi) ose të ndara, sepse Allahu i Lartësuar nuk e ka vënë kusht agjërimin e tyre radhazi, e po ashtu as i Dërguari i Tij (paqja qoftë mbi të!). Më e mira është që agjërimi i shtatë ditëve të shtyhet derisa personi të kthehet te familja e tij, për shkak të fjalës së Allahut të Lartësuar:

{...وَسَبْعَةَ إِذَا رَجَعْتُمْ...}

"...dhe shtatë ditë pas kthimit nga haxhi..." (El Bekare, 196)

Agjërimi për atë që nuk ka mundësi të therë kurban është më i mirë se t'u kërkojë sundimtarëve apo njerëzve të tjerë një kurban për ta therur për veten e tij. Ai të cilit i jepet një kurban ose diçka tjetër pa e kërkuar dhe pa e lakmuar, mund ta marrë dhe nuk ka asgjë të keqe në këtë, edhe nëse është duke kryer haxhin për dikë tjetër; domethënë, nëse personi që e ka autorizuar nuk i ka vënë kusht që ta blejë kurbanin me paratë që i ka dhënë. Ndërsa sa i përket asaj që bëjnë disa njerëz, duke i kërkuar qeverisë apo të tjerëve kurbanë në emër të personave të caktuar, ndërkohë që gënjejnë, kjo pa dyshim është e ndaluar, sepse është përfitim përmes gënjeshtërs. Allahu na ruajttë ne dhe muslimanët nga kjo!

KAPITULLI XII:

OBLIGUESHMËRIA E URDHËRIMIT PËR MIRË PËR HAXHINJTË DHE NJERËZIT E TJERË

Prej obligimeve më madhështore për haxhinjtë dhe të tjerët është urdhërimi për mirë e ndalimi nga e keqja dhe kujdesi për faljen e pesë namazeve me xhemat, ashtu siç ka urdhëruar Allahu për këtë në Librin e Tij dhe nëpërmjet gjuhës së të Dërguarit të Tij (paqja qoftë mbi të!).

Ndërsa veprimi i shumë njerëzve, banorë të Mekës e të tjerë, që falen në shtëpi dhe i braktisin xhamitë, është gabim dhe është në kundërshtim me Sheriatin. Prandaj, kjo duhet ndaluar dhe njerëzit duhen urdhëruar që të kujdesen për faljen e namazit në xhami, sepse është vërtetuar se Profeti (paqja qoftë mbi të!) i ka thënë Ibën Umri Mektumit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), kur ky i kërkoi leje që të falet në shtëpi, për shkak se ishte i verbër dhe e kishte shtëpinë larg xhamisë:

«هَلْ تَسْمَعُ الْإِذَاءَ بِالصَّلَاةِ؟ قَالَ: نَعَمْ، قَالَ: فَأَجِبْ»،

“A e dëgjon ezanin?” Tha: “Po.” Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) i tha: “Atëherë përgjigju!”¹ Në një transmetim tjetër thuhet:

«لَا أُجِزُكَ رُحْصَةً»،

¹ Transmetuan Buhariu nr. 2420 dhe Muslimi nr. 651.

“Nuk gjej ndonjë lehtësim për ty.”¹ Po kështu ka thënë:

«لَقَدْ هَمَمْتُ أَنْ أَمَرَ بِالصَّلَاةِ فَنُقَامَ، ثُمَّ أَمَرَ رَجُلًا فَيُؤَمِّمَ النَّاسَ، ثُمَّ أَنْطَلِقَ إِلَى رِجَالٍ لَا يَشْهَدُونَ الصَّلَاةَ فَأَحْرِقَ عَلَيْهِمْ بُيُوتَهُمْ بِالنَّارِ»،

"Më ka shkuar mendja të urdhëroj të thirret ikameti për faljen e namazit, pastaj të caktoj një njeri t'u prijë njerëzve, e unë të shkoj te disa burra që nuk vijnë të falin namazin (në xhami) e t'ua djeg shtëpitë me zjarr, bashkë me ta brenda."² Në Sunenin e Ibn Maxhes dhe në koleksione të tjera transmetohet me zinxhir të mirë nga Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ سَمِعَ النِّدَاءَ فَلَمْ يَأْتِ فَلَا صَلَاةَ لَهُ إِلَّا مِنْ عُذْرٍ» [95],

“Nuk ka namaz ai që e dëgjon ezanin e nuk vjen, përveçse nëse ka ndonjë arsye.” (95)³ Në Sahihun e Muslimit ceket se Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: “Kush dëshiron që ta takojë Allahun nesër si musliman, le të jetë i kujdesshëm ndaj faljes së këtyre namazeve aty ku thirret ezani për faljen e tyre, sepse Allahu ia ka ligjësuar Profetit tuaj sunetet e udhëzimit dhe këto (namazet me xhemat) janë prej suneteve të udhëzimit. Sikur të faleshit në shtëpitë tuaja, ashtu siç falet në shtëpinë e tij ai që nuk shkon në xhami,

¹ Transmetoi Muslimi nr. 653, nga Ebi Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të.

² Transmetoi Ebu Daudi nga Abdullah ibën Umri Mektum nr. 552.

³ Transmetoi Muslimi nr. 654.

do ta kishit braktisur sunetin e Profetit tuaj. E sikur ta braktisnit sunetin e Profetit tuaj, do të devijonit. Çdo njeri që pastrohet (merr abdes) në mënyrën më të mirë, pastaj i drejtohet njëres prej këtyre xhamive, Allahu ia shkruan një të mirë për çdo hap që hedh, e ngre një gradë dhe ia shlyen një gjynah. Ne e kemi parë (në kohën tonë) se nuk mungonte prej tij (namazit me xhemat), përveç një munafiku, hipokrizia e të cilit ishte e njohur. Madje, edhe të sëmurin e sillnin përkrahësh dhe e vendosnin në saf.”¹

Haxhinjtë dhe njerëzit e tjerë e kanë obligim t'u shmangen ndalesave të Allahut të Lartësuar dhe të ruhen nga kryerja e tyre, si: imoraliteti, homoseksualizmi, vjedhja, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, mashtrimi në marrëdhëniet tregtare, tradhtia në gjërat e lëna amanet, pirja e pijeve dehëse, pirja e duhanit, lëshimi i rrobave nën kyçin e këmbës, mendjemadhësia, zilia, syfaqësia, përgojimi, shpifja, tallja me muslimanët, përdorimi i instrumenteve muzikore, si: gramafoni, harpa, lahuta, fyelli etj. Si dhe dëgjimi i këngëve dhe i instrumenteve muzikore nga radioja apo nga burime të tjera, luajtja me zare, shah, pjesëmarrja në lojërat e fatit - kumari- vizatimi apo fotografimi i qenieve me shpirt, qofshin njerëz apo qenie tjera, si dhe të qenit

¹ Transmetoi Ebu Davudi nr. 551.

i kënaqur me këto gjëra, sepse të gjitha këto janë punë të këqija që Allahu ua ka ndaluar robërve të Tij në çdo kohë dhe në çdo vend. Prandaj, haxhinjtë dhe banorët e Shtëpisë së Shenjtë të Allahut duhet të ruhen prej tyre më shumë se të tjerët; sepse mëkatet në këtë Qytet të Sigurt janë më të rënda dhe dënimi për to është më i madh.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿...وَمَنْ يُرِدْ فِيهِ بِالْحَادِ بِظُلْمٍ نُذِقْهُ مِنْ عَذَابِ أَلِيمٍ 25﴾

"...ata që synojnë ta përdhosin (Xhaminë e Shenjtë), me heretizëm, Ne do t'i bëjmë të shijojnë dënim të dhembshëm." (El Haxh, 25) Nëse Allahu e ka kërcënuar atë që synon të bëjë ndonjë herezi në Vendin e Shenjtë, atëherë si do të jetë ndëshkimi për atë që e vepron atë?! Pa dyshim, ai (ndëshkimi) është më i madh dhe më i ashpër. Prandaj, duhet ruajtur nga kjo, si dhe nga të gjitha gjynahet e tjera.

Haxhinjtë nuk mund të arrijnë t'u pranohet haxhi dhe faljen e mëkateve, veçse duke u ruajtur nga këto mëkate dhe të tjera që Allahu ua ka ndaluar, siç thuhet në hadithin e Profetit (paqja qoftë mbi të!):

«مَنْ حَجَّ فَلَمْ يَرْفُثْ وَلَمْ يَفْسُقْ رَجَعَ كَيَوْمٍ وَلَدَتْهُ أُمُّهُ».

"Ai që e kryen haxhillëkun duke u larguar nga veprimet intime bashkëshortore, fjalët e pahijshme

dhe mëkatet, kthehet sikurse ditën që e ka lindur nëna.”¹

Më e rëndë dhe më e madhe se këto të këqija është: lutja e të vdekurve, kërkimi i ndihmës prej tyre, zotimi për ta dhe flijimi i kafshëve për ta; me shpresën se ata do të ndërmjetësojnë për lutësin e tyre tek Allahu, ose me shpresën se do t'ia shërojnë njeriun e sëmurë, ose do t'ia kthejnë njeriun e humbur, etj.

Ky është shirku i madh, të cilin Allahu e ka ndaluar, dhe kjo ishte feja e idhujtarëve të kohës së injorancës. Allahu i ka dërguar të Dërguarit dhe ka zbritur Librat për ta kritikuar dhe ndaluar këtë shirk.

Prandaj, është obligim për çdo individ, haxhi apo jo, që t'i ruhet këtij shirku, të pendohet tek Allahu për çdo gjë të tillë që mund të ketë bërë në të kaluarën dhe të fillojë një haxh të ri pas pendimit prej tij; sepse shirku i madh i prish të gjitha veprat, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar:

{وَلَوْ أَشْرَكُوا لَحَبِطَ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ 88}

"Por, nëse ata adhurojnë zota të tjerë, do t'u asgjësohet çdo gjë që kanë bërë." (El Enam, 88)

Nga llojet e shirkut të vogël është betimi në dikë tjetër përveç Allahut, si p.sh. në Profetin (paqja qoftë mbi të), në Qabe, në amanet (besë) etj.

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1521 dhe Muslimi nr. 1350, nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Prej këtyre gjërave janë edhe: syfaqësia dhe fama, si dhe thëniet: “Si të dojë Allahu dhe si të duash ti!”, “Sikur të mos ishte Allahu dhe ti”, “Kjo është prej Allahut dhe prej teje” etj.

Prandaj, është obligim ruajtja nga këto vepra të urryera pagane dhe porositja e njëri-tjetrit për braktisjen e tyre. Transmetohet nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«مَنْ حَلَفَ بِغَيْرِ اللَّهِ فَقَدْ كَفَرَ أَوْ أَشْرَكَ» [98].

"Ai që betohet në dikë tjetër përveç Allahut, ka bërë kufër ose shirk."(98)¹ E shënojnë Ahmedi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu me zinxhir të saktë të transmetuesve.

Në Sahihun e Buhariut përcillet nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ كَانَ حَالِفًا فَلْيَحْلِفْ بِاللَّهِ أَوْ لِيَصْنُتْ» [99].

"Kushdo që betohet, le të betohet në Allahun ose le të heshtë."(99)² Po kështu Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ حَلَفَ بِالْأَمَانَةِ فَلَيْسَ مِنَّا».

"Ai që betohet në amanet (besë), nuk është prej nesh."³ E shënon Ebu Davudi.

Po ashtu ka thënë:

¹ Transmetoi Ebu Davudi nr. 3251.

² Transmetoi Ebu Davudi nr. 3253.

³ Transmetuan Buhariu nr. 2679 dhe Muslimi nr. 1646.

«أَخَوْفُ مَا أَخَافُ عَلَيْكُمُ الشِّرْكَ الْأَصْغَرَ، فَسُئِلَ عَنْهُ فَقَالَ: الرَّيَاءُ».

"Gjëja që kam më së shumti frikë për ju është shirku i vogël. U pyet rreth tij, e tha: "Syfaqësia."¹ Po kështu ka thënë:

«لَا تَقُولُوا: مَا شَاءَ اللَّهُ وَشَاءَ فَلَانٌ، وَلَكِنْ قُولُوا مَا شَاءَ اللَّهُ ثُمَّ شَاءَ فَلَانٌ».

"Mos thoni: "Si të dojë Allahu dhe si të dojë filani!", por thoni: "Si të dojë Allahu, pastaj si të dojë filani!"² Nesaiu transmeton nga Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) se një burrë tha: "O i Dërguari i Allahut, si të dojë Allahu dhe si të duash ti!". Pejgamberi i tha:

«أَجَعَلْتَنِي لِلَّهِ نِدَاءً، بَلْ مَا شَاءَ اللَّهُ وَحْدَهُ».

"A më bëre mua rival me Allahun? Përkundrazi, si të dojë Allahu i Vetëm!"³

Këto hadithe dëshmojnë për mbrojtjen e Profetit (paqja qoftë mbi të!) ndaj rëndësisë së teuhidit, si dhe për paralajmërimin e umetit të tij nga shirku i madh dhe i vogël, dhe dëshmojnë gjithashtu për kujdesin që ai tregonte në pastrimin e besimit të tyre dhe shpëtimin e tyre nga dënimi i Allahut dhe shkaqet e zemërimit të Tij. Allahu e shpërbleftë për këtë me shpërblimin më të mirë, pasi që ai e përcolli mesazhin dhe e paralajmëroi umetin, dhe ishte i sinqertë me Allahun dhe robërit e Tij. Paqja dhe

¹ Transmetoi Ahmedi 5/428.

² Transmetoi Ebu Davudi nr. 4980.

³ Transmetoi Ibn Maxheh nr. 2117.

bekimet e përhershme të Allahut qofshin mbi të deri në Ditën e Gjykimit.

Është obligim për dijetarët nga mesi i haxhinjve dhe banorëve të Mekës dhe të Medinës, që t'ua mësojnë njerëzve dispozitat që Allahu ka ligjësuar për ta dhe t'i paralajmërojnë ata nga llojet e shirkut dhe mëkatet që Allahu ua ka ndaluar, t'ia shpjegojnë dhe sqarojnë atyre këto çështje me argumente të detajuara duke mos lënë asnjë paqartësi, në mënyrë që njerëzit të dalin nga errësira në dritë. Duke vepruar kështu, ata përmbushin detyrën e kumtimit dhe shpjegimit që Allahu ua ka ngarkuar mbi supe. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ لَتُبَيِّنُنَّهُ لِلنَّاسِ وَلَا تَكُنُوهُ...﴾

"Kujtoje (o Muhamed) kohën kur Allahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri se do t'ua shpjegojnë atë njerëzve dhe nuk do të fshehin asgjë nga ai..." (Al Imran, 187)

Qëllimi i këtij ajeti është: paralajmërimi i dijetarëve të këtij umeti që të mos ndjekin rrugën e zullumqarëve prej ithtarëve të Librit në fshehjen e së vërtetës, duke i dhënë përparësi jetës kalimtare para asaj të përhershme. I Lartësuari thotë:

﴿إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُمُونَ مَا أَنْزَلْنَا مِنَ الْبَيِّنَاتِ وَالْهُدَىٰ مِنْ بَيْنَاهُ لِلنَّاسِ فِي الْكِتَابِ أُولَٰئِكَ يَلْعَنُهُمُ اللَّهُ وَيَلْعَنُهُمُ اللَّاعِنُونَ 159 إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا وَأَصْلَحُوا وَبَيَّنُّوا فَأُولَٰئِكَ أَتُوبُ عَلَيْهِمْ وَأَنَا التَّوَّابُ الرَّحِيمُ 160﴾

"Me të vërtetë, ata që fshehin shpalljet Tona të qarta, pasi ua kemi shpjeguar njerëzve në Libër (Teurat), do të mallkohen nga Allahu dhe do të mallkohen nga ata (engjëj e njerëz) që janë ngarkuar të mallkojnë.

Përveç atyre që pendohen, përmirësohen dhe tregojnë atë që kishin fshehur, Unë ua pranoj pendimin, sepse Unë jam Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti." (El Bekare, 159-160) Ajetet kuranore dhe hadithet profetike dëshmojnë se thirrja për tek Allahu i Lartësuar dhe udhëzimi i robërve të Tij drejt qëllimit për të cilin janë krijuar, është prej veprave më të mira dhe detyrave më të rëndësishme, dhe se kjo është rruga e të dërguarve dhe e pasuesve të tyre deri në Ditën e Kiametit. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَنْ أَحْسَنُ قَوْلًا مِّمَّنْ دَعَا إِلَى اللَّهِ وَعَمِلَ صَالِحًا وَقَالَ إِنِّي مِنَ الْمُسْلِمِينَ 33﴾

"E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: "Unë, me të vërtetë jam musliman." (Fusilet, 33) Gjithashtu Allahu i Lartmadhëruar thotë:

﴿قُلْ هَذِهِ سَبِيلِي أَدْعُو إِلَى اللَّهِ عَلَى بَصِيرَةٍ أَنَا وَمَنِ اتَّبَعَنِي وَسُبْحَانَ اللَّهِ وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ 108﴾

"Thuaj: "Kjo është rruga ime: unë ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua. I përlëvduar qoftë Allahu; unë nuk jam prej idhujtarëve!" (Jusuf, 108)

Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ دَلَّ عَلَى خَيْرٍ فَلَهُ مِثْلُ أَجْرِ فَاعِلِهِ»

"Atij që udhëzon drejt një mirësie, i takon shpërblimi sikurse atij që e vepron."¹

[105] «لَأَنْ يَهْدِيَ اللَّهُ بِكَ رَجُلًا وَاحِدًا خَيْرٌ لَكَ مِنْ حُمْرِ النَّعَمِ»

"Të udhëzojë Allahu nëpërmjet teje një njeri, është më mirë për ty se devetë e kuqe."(105)² Ajetet dhe hadithet që kanë këtë kuptim janë të shumta.

Prandaj, është detyrë e dijetarëve dhe besimtarëve që t'i dyfishojnë përpjekjet e tyre në thirrjen për tek Allahu i Lartësuar, t'i udhëzojnë robërit e Tij drejt shkaqeve të shpëtimit dhe t'i paralajmërojnë nga shkaqet e shkatërrimit, sidomos në këtë kohë kur kanë mbizotëruar epshet, janë përhapur parimet shkatërruese dhe sloganet mashtruese, janë pakësuar thirrësit e udhëzimit dhe janë shtuar thirrësit e ateizmit dhe liberalizmit. Allahut i kërkojmë ndihmë, nuk ka fuqi as forcë përveçse me Allahun, të Lartin, të Madhin.

KAPITULLI XIII:

PËLQYESHMËRIA E SHTIMIT TË ADHURIMEVE

Është e pëlqyer për haxhinjtë që gjatë qëndrimit të tyre në Mekë t'i përkushtohen dhikrit të Allahut, adhurimit dhe veprave të mira, të shtojnë namazin dhe tavafin rreth Shtëpisë së Shenjtë; ngase

¹ Muslimi nr. 1893.

² Transmetuan Buhariu nr. 3009 dhe Muslimi nr. 2406.

shpërblimi për veprat e mira në Vendin e Shenjtë është shumëfish, ndërsa gjynahet në të janë të mëdha e të rënda. Po ashtu, është e pëlqyer për ta që të shtojnë salavatet dhe selamet për të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!).

Kur haxhinjtë duan të dalin nga Meka, e kanë detyrim të bëjnë Tavafin e Lamtumirës, që ai të jetë veprimi i tyre i fundit në Qabe. Përveç gruas me menstruacione dhe lehonës, të cilat nuk e kanë detyrim këtë tavaf; sipas hadithit të Ibën Abbasit, Allahu qoftë i kënaqur me ta, i cili ka thënë:

«أَمَرَ النَّاسُ أَنْ يَكُونََ آخِرُ عَهْدِهِم بِالْبَيْتِ، إِلَّا أَنَّهُ خُفِّفَ عَنِ الْمَرْأَةِ الْحَائِضِ»

"Njerëzit u urdhëruan që veprimi i fundit i tyre të jetë tavafi në Qabe, përveç gruas me menstruacione, e cila u përjashtua nga urdhri si masë lehtësuese."¹

Pasi të përfundojë lamtumirën me Qabenë dhe të niset të dalë nga xhamia, ai ecën me fytyrë përpara (me kurriz nga Qabja), jo mbrapsht (me fytyrë nga Qabja); sepse një gjë e tillë nuk është transmetuar nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e as nga shokët e tij, përkundrazi, kjo është prej bidateve të shpikura. Dhe Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ عَمِلَ عَمَلًا لَيْسَ عَلَيْهِ أَمْرُنَا فَهُوَ رَدٌّ».

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1755 dhe Muslimi nr. 1328.

"Kushdo që bën ndonjë vepër që nuk është në përputhje me çështjen (fenë) tonë, ajo (vepër) është e refuzuar."¹ Po ashtu ka thënë:

إِيَّاكُمْ وَمُحَدَّثَاتِ الْأُمُورِ، فَإِنَّ كُلَّ مُحَدَّثَةٍ بِدْعَةٍ، وَكُلُّ بِدْعَةٍ ضَلَالَةٌ».

"...ruajuni nga gjërat e shpikura, ngase çdo gjë e shpikur është bidat dhe çdo bidat është lajthitje!"²

I lutemi Allahut të na bëjë të qëndrueshëm në fenë e Tij dhe të na ruajë nga çdo gjë që e kundërshton atë. Padyshim Ai është Dhënës dhe Bujarë.

KAPITULLI XIV:

DISPOZITAT DHE ETIKA E VIZITËS SË XHAMISË SË PROFETIT (PAQJA QOFTË MBI TË!)

Vizita e xhamisë së Profetit (paqja qoftë mbi të!) është sunet para haxhit ose pas tij, sepse është vërtetuar në dy Sahihët nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«صَلَاةٌ فِي مَسْجِدِي هَذَا خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ صَلَاةٍ فِيمَا سِوَاهُ إِلَّا الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ»
.[109]

"Një namaz në këtë xhaminë time është më i mirë sesa një mijë namaze në xhamitë e tjera, përveç Xhamisë së Shenjtë (Qabes)." (109)³ Ibën Umeri

¹ Burimi i tij është cekur më lart.

² Transmetoi Muslimi nr. 867, nga Xhabir bin Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

³ Transmetuan Buhariu nr. 1190 dhe Muslimi nr. 1394.

(Allahu qoftë i kënaqur me ta!) tregon se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«صَلَاةٌ فِي مَسْجِدِي هَذَا أَفْضَلُ مِنْ أَلْفِ صَلَاةٍ فِيْمَا سِوَاهُ إِلَّا الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ» [110]

“Një namaz në këtë xhaminë time është më i mirë se një mijë namaze në xhamitë e tjera, përveç Xhamisë së Shenjtë.” (110)¹ E transmeton Muslimi. Abdullah ibn Zubejri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«صَلَاةٌ فِي مَسْجِدِي هَذَا أَفْضَلُ مِنْ أَلْفِ صَلَاةٍ فِيْمَا سِوَاهُ إِلَّا الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ، وَصَلَاةٌ فِي الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ أَفْضَلُ مِنْ مِائَةِ صَلَاةٍ فِي مَسْجِدِي هَذَا» [111]

“Një namaz në këtë xhaminë time është më i mirë se një mijë namaze në xhamitë e tjera, përveç Xhamisë së Shenjtë, dhe një namaz në Xhaminë e Shenjtë është më i mirë se njëqind namaze në këtë xhaminë time.” (111)² E shënojnë Ahmedi, Ibën Khuzejmja dhe Ibën Hibani.

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«صَلَاةٌ فِي مَسْجِدِي هَذَا أَفْضَلُ مِنْ أَلْفِ صَلَاةٍ فِيْمَا سِوَاهُ، إِلَّا الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ، وَصَلَاةٌ فِي الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ أَفْضَلُ مِنْ مِائَةِ أَلْفِ صَلَاةٍ فِيْمَا سِوَاهُ»

“Një namaz në këtë xhaminë time është më i mirë sesa një mijë namaze në xhamitë e tjera, përveç Xhamisë së Shenjtë, dhe një namaz në Xhaminë e

¹ Transmetoi Muslimi nr. 1395.

² Transmetoi Ahmed i 4/5.

Shenjtë është më i mirë sesa njëqind mijë namaze në xhamitë e tjera.”¹ E shënojnë Ahmedi dhe Ibën Maxhe. Hadithet me këtë kuptim janë të shumta.

Kur vizitori arrin në xhaminë e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!), është e preferuar për të që të hyjë me këmbën e djathtë dhe të thotë: "Në emër të Allahut, paqja dhe bekimet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut. Kërkoj mbrojtje tek Allahu i Madhërishëm, me Fytyrën e Tij fisnike dhe me pushtetin e Tij të amshuar, prej djallit të mallkuar. O Allah, m’i hap mua dyert e mëshirës Sate."

Këtë e thotë sikurse e thotë kur hyn në xhamitë e tjera, pasi për hyrjen në xhaminë e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) nuk ka ndonjë lutje të veçantë.

Pastaj fal dy rekate dhe gjatë tyre i lutet Allahut për çfarëdo që dëshiron nga të mirat e kësaj bote dhe botës tjetër. E nëse i fal ato në Raudan e Nderuar, kjo është më mirë, ngase Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَا بَيْنَ بَيْتِي وَمَنْبَرِي رَوْضَةٌ مِنْ رِيَاضِ الْجَنَّةِ».

"Vendi mes shtëpisë sime dhe minberit tim është një kopsht prej kopshteve të Xhenetit." ² Pastaj, pas namazit, viziton varrin e Profetit (paqja qoftë mbi të!) dhe varret e dy shokëve të tij: Ebu Bekrit dhe Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Qëndron përballë varrit të Profetit (paqja qoftë mbi të!) me

¹ Transmetoi Ibën Maxheh nr. 1406.

² Transmetuan Buhariu nr. 1195 dhe Muslimi nr. 1390.

edukatë, pa e ngritur zërin, pastaj e përshëndet atë (paqja qoftë mbi të!) me fjalët: “Es-selamu alejke ja Resulallah, ue rahmetullahi ue berekatuhu”. Kjo bazohet në hadithin që transmetohet në Sunenin e Ebu Davudit me zinxhir të mirë, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ka thënë se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَا مِنْ أَحَدٍ يُسَلِّمُ عَلَيَّ إِلَّا رَدَّ اللَّهُ عَلَيَّ رُوحِي حَتَّى أَرُدَّ عَلَيْهِ السَّلَامَ».

"Nuk ndodh që dikush të më japë salam, veçse Allahu do të ma rikthejë shpirtin, derisa t'ia kthejë selamin."¹ Nëse vizitori gjatë përshëndetjes së tij thotë: “Paqja qoftë mbi ty, o Profet i Allahut! Paqja qoftë mbi ty, o më i miri i krijesave të Allahut! Paqja qoftë mbi ty, o prijës i të dërguarve dhe imam i të devotshmëve! Dëshmoj se ti e ke përcjellë mesazhin, e ke përmbushur amanetin, i ke këshilluar me dashamirësi njerëzit dhe ke luftuar në rrugë të Allahut siç duhet”, kjo nuk përbën problem, sepse të gjitha këto janë nga cilësitë e tij (paqja qoftë mbi të!). Gjithashtu le t'i dërgojë salavate atij (paqja qoftë mbi të!) dhe të lutet për të, pasi Sheriati e ka lejuar bashkimin midis salavateve dhe selameve për Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!), bazuar në fjalën e të Lartësuarit:

﴿إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا 56﴾

¹ Transmetoi Ebu Davudi nr. 2041.

"Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për të. O besimtarë, lutuni për të dhe përshëndeteni me "selam"! (El Ahzab, 56) Pastaj përshëndet Ebu Bekrin dhe Umerin (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!), lutet për ta dhe kërkon nga Allahu që të jetë i kënaqur me ta.

Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) kur përshëndeste Profetin (paqja qoftë mbi të!) dhe të dy shokët e tij, zakonisht nuk thoshte më shumë se: "Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut! Paqja qoftë mbi ty, o Ebu Bekër! Paqja qoftë mbi ty, o babai im!" Pastaj largohej.

Kjo vizitë është e lejuar vetëm për burrat. Sa i përket grave, atyre nuk u lejohet të vizitojnë asnjë varr, siç është vërtetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«لَعَنَ رُؤَاةَ الْقُبُورِ مِنَ النِّسَاءِ وَالْمُتَخَذِينَ عَلَيْهَا الْمَسَاجِدَ وَالسُّرُجَ».

"Allahu i ka mallkuar gratë që vizitojnë varret, si dhe ata që ndërtojnë faltore mbi to dhe vendosin kandila!"¹

Sa i përket udhëtimit drejt Medinës për faljen e namazit në xhaminë e të Dërguarit (paqja qoftë mbi të!), për të bërë lutje në të, dhe për gjëra tjera të ngjashme me këto, të cilat janë të lejuara edhe në xhamitë e tjera; gjëra të tilla janë të lejuara për të gjithë, bazuar në hadithet e lartpërmendura.

¹ Transmetoi Ebu Davudi nr. 3236.

Vizitorit i rekomandohet t'i falë pesë namazet në xhaminë e Profetit (paqja qoftë mbi të!), dhe të shtojë dhikrin, lutjet dhe namazet nafile, për të fituar shpërblimin e madh që gjendet në të.

Dhe është e pëlqyer të falë sa më shumë namaz vullnetar në Raudan e Nderuar, për shkak të hadithit të saktë të përmendur më parë që flet për vlerën e saj, ku Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) thotë:

«مَا بَيْنَ بَيْتِي وَمَنْبَرِي رَوْضَةٌ مِنْ رِيَاضِ الْجَنَّةِ».

"Vendi mes shtëpisë sime dhe minberit tim është një kopsht prej kopshteve të Xhenetit"¹

Ndërsa për namazin farz, vizitori, por dhe të tjerët, duhet të falen përpara dhe të kujdesen për safin e parë sa të munden, edhe nëse është në pjesën shtesë nga ana e kibles; kjo për shkak të haditheve të sakta që përcillen nga Profeti (paqja qoftë mbi të!), të cilat nxisin dhe inkurajojnë për faljen në safin e parë, si thënia e tij (paqja qoftë mbi të!):

«أَلَوْ يَعْلَمُ النَّاسُ مَا فِي النِّدَاءِ وَالصَّفِّ الْأَوَّلِ ثُمَّ لَمْ يَجِدُوا إِلَّا أَنْ يَسْتَهْمُوا عَلَيْهِ لَاسْتَهْمُوا»

"Sikur njerëzit ta dinin se çfarë vlere ka ezani dhe rreshti i parë, pastaj të mos gjenin mundësi tjetër përveçse të hidhnin short për to, ata do të hidhnin

¹ Burimi i tij është cekur më lart.

short.”¹ Ky hadith është unanimisht i saktë. Po kështu edhe fjala e tij (paqja qoftë mbi të!) drejtuar shokëve të tij:

«تَقَدَّمُوا فَأَتَمُّوا بِي وَلِيَأْتَمَّ بِكُمْ مِنْ بَعْدِكُمْ، وَلَا يَزَالُ الرَّجُلُ يَتَأَخَّرُ عَنِ الصَّلَاةِ حَتَّى يُؤَخَّرَهُ اللَّهُ»

"Ecni përpara dhe faluni pas meje, e le të falen pas jush ata që vijnë më pas, njeriu do të vazhdojë të ngelë prapa në namaz, derisa Allahu ta lërë atë prapa!"² Transmetoi Muslimi.

Ebu Davudi transmeton, nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), me zinxhir të mirë, se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«لَا يَزَالُ الرَّجُلُ يَتَأَخَّرُ عَنِ الصَّفِّ الْمَقْدَمِ حَتَّى يُؤَخَّرَهُ اللَّهُ فِي النَّارِ» [119].

"Njeriu do të vazhdojë të mbetet prapa nga safi i parë, derisa Allahu ta lërë atë prapa në Zjarr." (119)³ Gjithashtu është vërtetuar prej tij (paqja qoftë mbi të!) se u ka thënë sahabëve të tij:

«أَلَا تَصُفُّونَ كَمَا تَصُفُّ الْمَلَائِكَةُ عِنْدَ رَبِّهَا؟ قَالُوا: يَا رَسُولَ اللَّهِ، وَكَيْفَ تَصُفُّ الْمَلَائِكَةُ عِنْدَ رَبِّهَا؟ قَالَ: يُتِمُّونَ الصُّفُوفَ الْأُولَى، وَيَتَرَاصُّونَ فِي الصَّفِّ»

"Përse nuk rreshtoheni siç rreshtohen engjëjt para Zotit të tyre?" Ata i thanë: "O i dërguari i Allahut, si rreshtohen engjëjt para Zotit të tyre?" Ai tha: "Ata i

¹ Transmetoi Muslimi nr. 438, nga Ebu Seid el-Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

² Transmetuan Buhariu nr. 615 dhe Muslimi nr. 437.

³ Transmetoi Muslimi nr. 430, nga Xhabir bin Semura.

plotësojnë rreshtat e parë dhe i ngjeshin radhët.”¹ E shënon Muslimi.

Hadithet me këtë kuptim janë të shumta dhe ato përfshijnë xhaminë e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) dhe të tjerat, si para zgjerimit të saj, ashtu edhe pas tij. Është vërtetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) se ai i nxiste shokët e tij për t'u falur në anët e djathta të rreshtave. Dihet se ana e djathtë e rreshtit në xhaminë e tij të hershme ishte jashtë Raudas. Nga kjo kuptohet se kujdesi për t'u falur në rreshtat e parë dhe në anët e djathta të tyre ka përparësi ndaj kujdesit për t'u falur në Raudan e Nderuar, dhe se falja në mënyrë të rregullt në to ka më shumë përparësi sesa falja e namazit në Rauda. Kjo është e qartë për këdo që mediton mbi hadithet që janë transmetuar lidhur me këtë çështje. Suksesi vjen nga Allahu.

Nuk lejohet që dikush të prekë dhomën e Profetit, ta puthë atë apo të bëjë tavaf rreth saj, sepse kjo nuk është përcjellë nga selefët e mirë, përkundrazi, është një bidat i urryer.

Nuk lejohet që dikush t'i kërkojë Profetit (paqja qoftë mbi të!) plotësimin e ndonjë nevoje, largimin e ndonjë brengje, shërimit e ndonjë të sëmuri, apo gjëra të tjera të ngjashme me këto; sepse të gjitha këto nuk kërkohen nga askush tjetër pos Allahut,

¹ Transmetoi Ebu Davudi nr.679 dhe teksti është: "Do të vazhdojnë disa njerëz të mbesin prapa nga rreshti i parë, derisa Allahu t'i lërë ata prapa në Zjarr."

dhe kërkimi i tyre nga të vdekurit është shirk ndaj Allahut dhe adhurim kushtuar dikujt tjetër pos Tij. Feja islame është e ndërtuar mbi dy themele:

E para: të adhurohet vetëm Allahu.

E dyta: të mos adhurohet veçse sipas asaj që ka ligjësuar i Dërguari (paqja qoftë mbi të!).

Dhe kjo është domethënia e dëshmisë se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij.

Po kështu, nuk i lejohet askujt të kërkojë ndërmjetësim nga Profeti (paqja qoftë mbi të!), ngase ai i takon vetëm Allahut të Lartësuar, andaj nuk kërkohet veçse prej Tij, siç ka thënë i Lartësuari:

(قُلْ لِلَّهِ الشَّفَاعَةُ جَمِيعًا...)

"Thuaju: 'Ndërmjetësimi i përket i gjithi Allahut...'" (Ez Zumer, 44) Prandaj, thuaj: "O Allah, bëje profetin Tënd ndërmjetësues për mua! O Allah, bëji engjëjt e Tu dhe robërit e Tu besimtarë ndërmjetësues për mua! O Allah, bëji ndërmjetësues për mua fëmijët e mi që kanë vdekur të vegjël!" etj. Ndërkaq, prej të vdekurve nuk kërkohet asgjësend, as ndërmjetësimi e asgjë tjetër, pavarësisht nëse kanë qenë profetë apo jo, ngase kjo gjë nuk është e ligjësuar dhe ngase të vdekurve i janë ndërprerë veprat, përveç veprave që i ka përjashtuar Ligjvënësi.

Në Sahihun e Muslimit, Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِذَا مَاتَ ابْنُ آدَمَ انْقَطَعَ عَمَلُهُ إِلَّا مِنْ ثَلَاثٍ: صَدَقَةٍ جَارِيَةٍ، أَوْ عِلْمٍ يُنْتَفَعُ بِهِ، أَوْ وَلَدٍ صَالِحٍ يَدْعُو لَهُ».

“Kur të vdesë njeriu, i ndërpriten (shpërblimet për) veprat, përveç tri veprave: lëmoshës rrjedhëse, dijes prej së cilës kanë dobi (njerëzit) dhe fëmijës së mirë që lutet për të.”¹

Lejohet kërkimi i ndërmjetësimit nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) gjatë jetës së tij dhe në Ditën e Gjykimit, për shkak të mundësisë së tij për këtë, sepse në këto raste ai e ka mundësinë që t'i lutet Zotit të tij për atë që ia kërkon këtë gjë. Për sa i përket kësaj bote, kjo kuptohet dhe kjo nuk është vetëm për të veçanërisht, por është e përgjithshme si për të, ashtu edhe për besimtarët e tjerë. Prandaj, i lejohet muslimanit t'i thotë vëllait të tij: “Ndërmjetëso për mua te Zoti im për këtë e atë çështje!”, që do të thotë: “Lute Allahun për mua!”. Po ashtu, i lejohet edhe atij që i drejtohet kjo kërkesë që t'i lutet Allahut dhe të ndërmjetësojë për vëllain e tij, nëse kërkesa në fjalë është prej gjërave që Allahu i ka lejuar.

¹ Transmetoi Muslimi nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të!, nr. 1631.

Ndërsa në Ditën e Kijametit, askush nuk mund të ndërmjetësojë përveçse me lejen e Allahut të Lartësuar, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿...مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ...﴾

"Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?" (El Bekare, 255)

Sa i përket gjendjes së vdekjes, ajo është një gjendje e veçantë, e cila nuk duhet të barazohet me gjendjen e njeriut para vdekjes e as me gjendjen e tij pas ringjalljes, sepse të vdekurit i ndërpriten veprat dhe ai është peng i asaj që ka punuar, përveç atyre që i ka përjashtuar Ligjvënësi. Kërkimi i ndërmjetësimit nga të vdekurit nuk bën pjesë në gjërat që i ka përjashtuar Ligjvënësi, prandaj nuk lejohet të renditet me to. Pa dyshim se Profeti (paqja qoftë mbi të!) pas vdekjes së tij është i gjallë në jetën e Berzahut, e cila është më e përsosur se jeta e dëshmorëve, mirëpo kjo jetë nuk është si jeta e tij para vdekjes e as si jeta e tij në Ditën e Kiametit, por është një jetë, realitetin dhe formën e së cilës e di vetëm Allahu i Lartësuar. Për këtë arsye, në një hadith fisnik përcillet se ai (paqja qoftë mbi të!) ka thënë :

«مَا مِنْ أَحَدٍ يُسَلِّمُ عَلَيَّ إِلَّا رَدَّ اللَّهُ عَلَيَّ رُوحِي حَتَّى أَرُدَّ عَلَيْهِ السَّلَامَ»

"Nuk ndodh që dikush të më japë salam, veçse Allahu ma rikthen shpirtin, që t'ia kthej atij selamin."¹

Kjo tregon se ai ka vdekur dhe se shpirti i tij është ndarë nga trupi i tij, por i kthehet atij kur i jepet salam. Tekstet nga Kurani dhe Suneti që dëshmojnë për vdekjen e tij (paqja qoftë mbi të!) janë të njohura, dhe kjo është një çështje për të cilën pajtohen dijetarët. Megjithatë, kjo nuk e mohon jetën e tij të Berzahut, ashtu siç vdekja e dëshmorëve nuk e mohon jetën e tyre të Berzahut, siç përmendet në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿وَلَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ قُتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَمْوَاتًا بَلْ أَحْيَاءٌ عِنْدَ رَبِّهِمْ يُرْزَقُونَ﴾ (169)

"Kurrresi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre." (Al Imran, 169)

E shtjelluam këtë çështje për shkak të nevojës, pasi ka shumë njerëz që krijojnë paqartësi në këtë temë dhe thërrasin në shirk e në adhurimin e të vdekurve përveç Allahut. Andaj, i lutemi Allahut për veten tonë dhe për të gjithë muslimanët të na ruajë nga çdo gjë që kundërshton Sheriatin e Tij. Allahu është më i Dijshmi.

Ajo që bëjnë disa vizitorë duke ngritur zërin pranë varrit të Profetit (paqja qoftë mbi të!) dhe duke qëndruar gjatë aty, është në kundërshtim me atë që është e ligjësuar; sepse Allahu i Lartësuar e

¹ Transmetoi Ebu Davudi nr. 2041.

ka ndaluar umetin që t'i ngrenë zërat e tyre mbi zërin e Profetit (paqja qoftë mbi të!) dhe t'i drejtohen atij me zë të lartë siç i drejtohen njëritjetrit, dhe i ka urdhëruar ta ulin zërin kur janë pranë tij. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَرْفَعُوا أَصْوَاتَكُمْ فَوْقَ صَوْتِ النَّبِيِّ وَلَا تَجْهَرُوا لَهُ بِالْقَوْلِ كَجَهْرِ بَعْضِكُمْ لِبَعْضٍ أَنْ تَحْبَطَ أَعْمَالُكُمْ وَأَنْتُمْ لَا تَشْعُرُونَ 2 إِنَّ الَّذِينَ يَغْضَوْنَ أَصْوَاتَهُمْ عِنْدَ رَسُولِ اللَّهِ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ امْتَحَنَ اللَّهُ قُلُوبَهُمْ لِلتَّقْوَىٰ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ عَظِيمٌ 3﴾

"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëritjetrit, në mënyrë që të mos ju zhvlerësohen veprat tuaja pa e kuptuar!

Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh" (Huxhurat: 2–3)

Qëndrimi i gjatë dhe përsëritja e përsëritjes shkakton dyndje dhe radhë njerëzish, zhurmë dhe ngritje zërash – gjë që bie ndesh me rregullat e përcaktuara nga Allahu në këto ajete. Ai (paqja qoftë mbi të!) është i nderuar si gjallë ashtu edhe i vdekur, dhe nuk i takon besimtarit të kundërshtojë etikën fetare pranë varrit të tij.

Po ashtu, ajo që bëjnë disa vizitorë dhe të tjerë duke u përpjekur të luten pranë varrit të tij, kthyer me fytyrë nga varri dhe duke ngritur duart, e gjithë kjo bie ndesh me traditën e brezave të parë të mirë, shokëve të të Dërguarit të Allahut dhe atyre që i

ndoqën me vepra të mira. Bile, kjo është prej risive të shpikura në fe, dhe Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«فَعَلَيْكُمْ بِسُنَّتِي وَسُنَّةِ الْخُلَفَاءِ الرَّاشِدِينَ الْمَهْدِيِّينَ مِنْ بَعْدِي، تَمَسَّكُوا بِهَا وَعَضُّوا عَلَيْهَا بِالنَّوَاجِذِ، وَإِيَّاكُمْ وَمُحَدَّثَاتِ الْأُمُورِ، فَإِنَّ كُلَّ مُحَدَّثَةٍ بِدْعَةٌ وَكُلَّ بِدْعَةٍ ضَلَالَةٌ».

"Kapuni fort pas traditës sime dhe traditës së kalifëve të drejtë e të përudhur pas meje, shtrëngojeni me dhëmballë, dhe ruajuni nga gjërat e shpikura, ngase çdo gjë e shpikur është bidat dhe çdo bidat është lajthitje!"¹

Po kështu ka thënë:

«مَنْ أَحْدَثَ فِي أَمْرِنَا هَذَا مَا لَيْسَ مِنْهُ فَهُوَ رَدٌّ»

"Kushdo që shpik në çështjen (fenë) tonë diçka që nuk është prej saj, ajo gjë është e refuzuar."²

«مَنْ عَمِلَ عَمَلًا لَيْسَ عَلَيْهِ أَمْرُنَا فَهُوَ رَدٌّ».

"Kushdo që bën ndonjë vepër që nuk është në përputhje me çështjen (fenë) tonë, ajo (vepër) është e refuzuar."³

Ali ibën Husejn Zejnul Abidini (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) pa një njeri duke u lutur pranë varrit të Profetit (paqja qoftë mbi të!), andaj e ndaloi dhe i tha: "A të të tregoj një hadith që e kam dëgjuar nga babai im, e ai nga gjyshi im, e ai nga i

¹ Transmetoi Ebu Davudi nga El-Irbad bin Sarijeh nr. 4607.

² Burimi i tij është cekur më lart.

³ Burimi i tij është cekur më lart.

Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!), se ai ka thënë:

«لَا تَتَّخِذُوا قَبْرِی عِیدًا، وَلَا بُیُوتَکُمْ قُبُورًا، وَصَلُّوا عَلَیَّ، فَإِنَّ تَسْلِیْمَکُمْ یَبْلُغُنِیْ اَیْمًا کُنْتُمْ».

"Mos e shndërroni varrin tim në vend feste dhe as shtëpitë tuaja në varre, dhe më dërgoni salavate, sepse selami juaj më arrin kudo që të jeni!"¹

Po ashtu, ajo që bëjnë disa vizitorë kur përshëndesin Profetin (paqja qoftë mbi të!) duke vënë dorën e djathtë mbi të majtën në gjoks si në namaz, nuk lejohet; as kur përshëndeten të tjerë si mbretër, udhëheqës apo të tjerë. Sepse kjo është një formë e qëndrimit për adhurim dhe përulësi që i takon vetëm Allahut – siç ka cituar Ibën Haxheri në librin e tij "Fet'h el-Bari" nga dijetarët. Kjo çështje është plotësisht e qartë për këdo që e mediton dhe ka për qëllim të ndjekë traditën e brezave të parë të mirë.

Sa i përket atij që është mposhtur nga fanatizmi, epshi, pasimi i verbër dhe mendimi i keq ndaj atyre që ftojnë në udhëzimin e selefëve të devotshëm, çështja e tij i takon Allahut. I lutemi Allahut të na japë neve dhe atij udhëzim dhe vullnet, që t'i japim përparësi të vërtetës mbi çdo gjë tjetër. Padyshim Ai është më i Miri i të luturve.

¹ Transmetimin e Zejnul Abidinit, shejhu ia atribuon Hafidh el-Makdisiut, i cili e ka shënuar hadithin pa e përmendur ngjarjen, si dhe Ahmedit në Musnedin e tij (2/367).

Po ashtu, ajo që bëjnë disa njerëz, kur i drejtohen varrit të nderuar (të Pejgamberit) prej së largu dhe lëvizin buzët për ta përshëndetur apo për t'u lutur, është njësoj si veprimet e mëparshme dhe konsiderohet risi në fe. Nuk i takon muslimanit të shpikë në fenë e tij atë që Allahu nuk e ka ligjësuar, dhe me këtë veprim ai është më afër të qenit i pasjellshëm sesa dashurisë dhe mirësjelljes. Imam Maliku (Allahu e mëshiroftë!) e ka kundërshtuar këtë veprim dhe veprimet e ngjashme me të, dhe ka thënë: "Të fundit e këtij ummeti nuk do të përmirësohen, përveçse me atë që u përmirësuan të parët e tij." (127)¹

Dihet se ajo që i përmirësoi të parët e këtij umeti ishte ndjekja e rrugës së Profetit (paqja qoftë mbi të!), kalifëve të tij të drejtë, shokëve të tij të mbarë dhe atyre që i pasuan ata me mirësi. Kështu që brezat e fundit të këtij umeti nuk do t'i përmirësojë gjë tjetër pos ndjekjes së kësaj rruge dhe ecjes në të.

Allahut i lutemi t'u japë vullnet muslimanëve që t'i përmbahen asaj që është shpëtim, lumturi dhe nder për ta, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Padyshim Ai është Dhënës dhe Bujarë.

¹ Igathetul-Lehfani fi Mesajidish-Shejtan (1/363).

VËREJTJE

GJYKIMI MBI VIZITËN E VARRIT TË PROFETIT (PAQJA QOFTË MBI TË!)

Vizita e varrit të Profetit (paqja qoftë mbi të!) nuk është e detyrueshme dhe as kusht për haxhin, siç mendojnë disa njerëz të thjeshtë dhe të tjerë si ata. Përkundrazi, ajo është vepër e pëlqyer për atë që viziton xhaminë e Profetit (paqja qoftë mbi të!) ose gjendet afër saj.

Ndërsa për atë që është larg Medines, nuk duhet ta ndër marrë udhëtimin me qëllim të vizitës së varrit, por duhet ta ndër marrë udhëtimin me qëllim të vizitës së xhamisë së Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!). E kur të mbërrijë aty, viziton varrin e nderuar të Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) dhe varrin e dy shokëve të tij. Kështu, vizita e varrit të tij (paqja qoftë mbi të!) dhe e varreve të dy shokëve të tij bëhet si diçka që përfshihet në vizitën e xhamisë së tij (paqja qoftë mbi të!), duke u bazuar për këtë në atë që përcillet në dy Sahihët, ku Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«لَا تُشَدُّ الرِّحَالُ إِلَّا إِلَى ثَلَاثَةِ مَسَاجِدَ: الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ، وَمَسْجِدِي هَذَا، وَالْمَسْجِدِ الْأَقْصَى».

“Nuk ndërmerret udhëtim përveçse për në tri xhami: Xhaminë e Shenjtë, Xhaminë time dhe Xhaminë el-Aksa.”¹

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1189 dhe Muslimi nr. 1397.

Sikur ndërmarrja e udhëtimit me qëllim të vizitës së varrit të tij (paqja qoftë mbi të!), apo të varrit të dikujt tjetër, të ishte e ligjshme, ai do ta kishte udhëzuar umetin për ta vepruar atë dhe do t'ua kishte treguar vlerën e saj; sepse ai ishte njeriu më këshillues, më i dituri për Allahun dhe më i devotshmi ndaj Tij. Ai e përcolli mesazhin në formën më të qartë, e udhëzoi umetin e tij drejt çdo të mire dhe i paralajmëroi nga çdo e keqe. Si pra, mund ta bëjë muslimani një gjë të tillë, kur ai ka paralajmëruar kundër ndërmarrjes së udhëtimit (në formë adhurimi) drejt vendeve të tjera përveç tri xhamive të lartpërmendura, dhe ka thënë:

«لَا تَتَّخِذُوا قَبْرِی عِیدًا، وَلَا بُیُوتَکُمْ قُبُورًا، وَصَلُّوا عَلَیَّ، فَإِنَّ صَلَاتَکُمْ تَبْلُغُنِی حَیثُ کُنْتُمْ»

"Mos e shndërroni varrin tim në vend feste dhe mos i shndërroni shtëpitë tuaja në varre! Më dërgoni salavate, sepse salavetet tuaja më arrijnë kudo që të jeni."¹

Mendimi se ndërmarrja e udhëtimit për të vizituar varrin e tij (paqja qoftë mbi të!) është e ligjshme, çon në shndërrimin e varrit të tij në vend feste dhe bën që njerëzit të përfshihen në ekstremizëm apo lavdrim të tepruar, të cilit i druhej Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!). Sikurse vërejmë se shumë njerëz janë përfshirë në këtë gabim për shkak të mendimit se ndërmarrja e udhëtimit për

¹ Burimi i tij është cekur më lart.

vizitën e varrit të Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) është e lejuar.

E sa i përket haditheve që përcillen në këtë temë, me të cilat argumentohen ata që thonë se lejohet ndërmarrja e udhëtimit për te varri i tij (paqja qoftë mbi të!), ato janë hadithe me zinxhirë transmetimi të dobët, madje të trilluara. Hafidhët si Darekutni, Bejhekiu, Ibën Haxheri etj, e kanë kanë vënë në dukje trillimin e tyre. Prandaj nuk lejohet që me to të kundërshtohen hadithet e sakta, të cilat dëshmojnë për ndalimin e ndërmarrjes së udhëtimit përveçse për te tri xhamitë kryesore.

Këtu po i sjellim lexuesit disa hadithe të shpikura që lidhen me këtë temë, në mënyrë që ai t'i njohë dhe të ruhet prej tyre:

I pari: “Kush bën haxh dhe nuk më viziton mua, ka treguar mungesë respekti ndaj meje.”

I dyti: “Kush më viziton pas vdekjes sime, është sikur më ka vizituar në jetë.”

I treti: “Kush më viziton mua dhe babain tim Ibrahimin në të njëjtin vit, i garantoj Xhenetin prej Allahut.”

I katërti: “Kush viziton varrin tim, e ka të sigurtë ndërmejtësimin tim.”

Këto hadithe dhe të tjera të ngjashme me to, nuk janë të sakta nga Profeti (paqja qoftë mbi të!).

Ibën Haxheri, pasi i ka cekur të shumtën e këtyre transmetimeve, në librin e tij (Et-Telhis) ka thënë:

“Të gjitha rrugët e transmetimit të këtij hadithi janë të dobëta.”

Hafidh Ukajli ka thënë: “Nuk është i saktë asnjë prej haditheve që përcillen në këtë temë.”

Shejhul-islam Ibn Tejmije (Allahu e pastë mëshiruar!) ka pohuar prerazi se të gjitha këto hadithe janë të shpikura. Dhe dija, memorizimi dhe njohuritë e tij të gjera të mjaftojnë si argument.

Sikur diçka prej këtyre haditheve të ishte e vërtetë, sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) do të ishin të parët që do ta zbatonin, do t'ia sqaronin umetit dhe do të thërrisnin në të; sepse ata janë njerëzit më të mirë pas profetëve, më të diturit për kufijtë e Allahut dhe për ligjet që Ai ka ligjësuar për robërit e Tij, dhe më të sinqertët ndaj Allahut dhe krijesave të Tij. Meqenëse prej tyre nuk është transmetuar asgjë e tillë, kjo tregon se ajo nuk është e ligjësuar.

Edhe sikur diçka prej tyre të ishte e saktë, do të ishte obligim që ajo të kuptohej si vizitë e ligjshme, e cila nuk përfshin ndërmarrjen e udhëtimit me qëllim vetëm vizitën e varrit; ngase në këtë mënyrë bëhet pajtimi mes haditheve. Allahu i Lartësuar është më Dijshmi.

KAPITULLI XV: PËLQYESHMËRIA E VIZITËS SË XHAMISË SË KUBASË DHE VARREZAVE TË BEKIËS

Vizitorit të Medinës i rekomandohet të vizitojë edhe xhaminë e Kubasë dhe të falë namaz në të, sipas hadithit të Ibën Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) që transmetohet në dy Sahihët, i cili ka thënë:

«كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَزُورُ مَسْجِدَ قُبَاءٍ رَاكِبًا وَمَاشِيًا وَيُصَلِّي فِيهِ رَكْعَتَيْنِ».

"Profeti (paqja qoftë mbi të!) e vizitonte xhaminë e Kubasë si në këmbë, ashtu edhe mbi kafshë, dhe falte dy rekate në të."¹

Sehël ibn Hunejfi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ تَطَهَّرَ فِي بَيْتِهِ ثُمَّ أَتَى مَسْجِدَ قُبَاءٍ فَصَلَّى فِيهِ صَلَاةً كَانَ لَهُ كَأَجْرِ عُمْرَةٍ».

"Kush pastrohet në shtëpinë e tij dhe vjen në xhaminë e Kubasë dhe fal në të një namaz, i llogaritet si shpërblim i një Umreje."²

Pëlqehet gjithashtu të vizitojë varrezat e Bekisë, varret e dëshmorëve dhe varrin e Hamzait (Allahu qoftë i kënaqur me të!), sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) i vizitonte dhe lutej për ta. Dhe sepse ai ka thënë:

«رُزُوا الْقُبُورَ فَإِنَّهَا تُذَكِّرُكُمْ بِالْآخِرَةِ» [132].

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1193 dhe Muslimi nr. 1399.

² Transmetoi Ibn Maxheh nr. 1412.

"Vizitoni varret, sepse ato ju kujtojnë Ahiretin!"¹
Transmetoi Muslimi.

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) i mësonte shokët e tij që kur të vizitonin varret të thoshin:

«السَّلَامُ عَلَيْكُمْ أَهْلَ الدِّيَارِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُسْلِمِينَ، وَإِنَّا إِن شَاءَ اللَّهُ بِكُمْ لَاحِقُونَ، نَسْأَلُ اللَّهَ لَنَا وَلَكُمْ الْعَافِيَةَ» [133].

"Paqja qoftë mbi ju, o banorë të këtyre varrezave, prej besimtarëve dhe muslimanëve. Edhe ne, nëse do Allahu, do t'ju bashkohemi. Kërkojmë prej Allahut mirësi për veten dhe për ju." (133)²
Transmetoi Muslimi nga hadithi i Sulejman ibën Burejdes, e ai nga babai i tij.

Transmeton Tirmidhiu nga Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ta!), se ka thënë: "Profeti (paqja qoftë mbi të!) kaloi pranë varreve të Medinës, u kthye me fytyrë nga to dhe tha:

«السَّلَامُ عَلَيْكُمْ يَا أَهْلَ الْقُبُورِ، يَغْفِرُ اللَّهُ لَنَا وَلَكُمْ، أَنْتُمْ سَلَفُنَا وَنَحْنُ بِالْآخِرِ» [134].

"Paqja qoftë mbi ju, o banorë të varreve. Allahu na faltë neve dhe juve. Ju jeni të parët tanë dhe ne do t'ju pasojmë." (134)³

Nga këto hadithe kuptohet se vizita e ligjësuar fetarisht e varreve ka si qëllim përkujtimin e Ahiretit, bamirësinë ndaj të vdekurve, bërjen e lutjeve dhe kërkimin e mëshirës për ta.

¹ Muslimi nr. 976.

² Transmetoi Muslimi nr. 975.

³ Transmetoi Tirmidhiu nr. 1035.

Ndërsa vizitat me qëllim bërjen e lutjes për vete pranë varreve të tyre, apo qëndrimi i vazhdueshëm pranë tyre, apo kërkesa për plotësimin e nevojave, shërimin e të sëmurëve, apo kërkesa nga Allahu për hir të tyre, apo për hir të pozitës së tyre; të gjitha janë vizita të ndaluara dhe të shpikura në fe, nuk i ka ligjësuar as Allahu e as i Dërguari i Tij, e as janë vepruar nga të parët e mirë (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Përkundrazi, ato janë prej veprave që i ka ndaluar i Dërguari (paqja qoftë mbi të!), dhe ka thënë:

«رُزُوا الْقُبُورَ، وَلَا تَقُولُوا هُجْرًا».

"Vizitoni varret, dhe mos thoni fjalë të kota!"¹

Çështjet e lartpërmendura janë të gjitha shpikje në fe (bidate), por ato i përkasin kategorive të ndryshme; disa prej tyre janë shpikje në fe, por jo shirk, si: lutja e Allahut pranë varreve dhe kërkesa drejtuar Atij për hir të të vdekurit dhe pozitës së tij, etj. Ndërsa disa të tjera janë prej shirkut të madh, si lutja e të vdekurve dhe kërkitimi i ndihmës prej tyre, etj.

Kjo çështje është sqaruar me hollësi më herët, prandaj bëhu i vëmendshëm dhe ki kujdes, dhe kërkoji Zotit tënd sukses dhe udhëzim për te e vërteta, sepse Ai, i Lartësuari, është Dhënësi i suksesit dhe Udhëzuesi dhe nuk ka të adhuruar dhe zot tjetër përveç Tij.

¹ Transmetoi Muslimi nga Ibn Burejde, nga babai i tij, nr. 977.

Këtu i erdhi fundi asaj që patëm dëshirë të shkruanim, falënderimet i takojnë Allahut, në fillim dhe në fund. Salavatet dhe selamet qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij, më të mirin e krijesave të Tij, Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij, dhe mbi ata që i pasojnë me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Përmbajtja

VERIFIKIMI DHE QARTËSIMI I SHUMË ÇËSHTJEVE QË KANË TË BËJNË ME HAXHIN, UMREN DHE VIZITËN E XHAMISË SË PEJGAMBERIT NË DRITËN E KURANIT DHE SUNETIT	3
VERIFIKIMI DHE SQARIMI I SHUMË ÇËSHTJEVE QË KANË TË BËJNË ME HAXHIN, UMREN DHE VIZITËN NË DRITËN E KURANIT DHE SUNETIT	3
PARATHËNIA E AUTORIT	3
KAPITULLI I:.....	5
ARGUMENTET E OBLIGUESHMËRISË SË HAXHIT DHE UMRES DHE NXITIMIT NË KRYERJEN E TYRE	5
KAPITULLI II:	9
OBLIGUESHMËRIA E PENDIMIT PËR MËKATET DHE HEQJES DORË NGA PADREJTËSITË	9
KAPITULLI III:	16
MBI VEPRIMET E HAXHIUT KUR MBËRRIN NË MIKAT	16
KAPITULLI IV:.....	22
MIKATET VENDORE DHE PËRCAKTIMI I TYRE.....	22
KAPITULLI V:	28
GJYKIMI MBI PERSONIN QË ARRIN TE MIKATI JASHTË MUAJVE TË HAXHIT.....	28
KAPITULLI VI:.....	31
GJYKIMI NË LIDHJE ME HAXHIN E FËMIJËS SË VOGËL, A VLEN AI PËR HAXHIN E DETYRUESHËM?.....	31
KAPITULLI VII:	34
SHPJEGIMI RRETH NDALESAVE TË IHRAMIT DHE GJËRAVE TË LEJUARA PËR MUHRIMIN (PERSONI QË KA HYRË NË IHRAM)	34
KAPITULLI VIII:.....	42

VEPRIMET E HAXHIUT KUR HYN NË MEKË DHE FORMA E KRYERJES SË TAVAFIT PAS HYRJES NË XHAMINË E SHENJTË	42
KAPITULLI IX:	51
DISPOZITA E HYRJES NË IHRAM PËR HAXH DITËN E TETË TË DHUL-HIXHXHES DHE DALJES PËR NË MINA	51
KAPITULLI X:	74
SQARIMI RRETH PËRPARËSISË SË VEPRAVE TË HAXHIUT NË DITËN E KURBANIT	74
KAPITULLI XI:	81
OBLIGUESHMËRA E KURBANIT PËR MUTEMET-TIUN DHE KARININ	81
KAPITULLI XII:	84
OBLIGUESHMËRIA E URDHËRIMIT PËR MIRË PËR HAXHINJTË DHE NJERËZIT E TJERË	84
KAPITULLI XIII:	93
PËLQYESHMËRIA E SHTIMIT TË ADHURIMEVE	93
KAPITULLI XIV:	95
DISPOZITAT DHE ETIKA E VIZITËS SË XHAMISË SË PROFETIT (PAQJA QOFTË MBI TË!)	95
VËREJTJE	111
GJYKIMI MBI VIZITËN E VARRIT TË PROFETIT (PAQJA QOFTË MBI TË!)	111
KAPITULLI XV:	115
PËLQYESHMËRIA E VIZITËS SË XHAMISË SË KUBASË DHE VARREZAVE TË BEKIËS	115